



**BASHKIA BERAT**

**PROJEKT BUXHETI I VITIT 2018**  
**&**  
**PBA PERFUNDIMTARE 2018-2020**

**PERGATITI: GRUPI PER MENAXHIM STATEGJIK**

**NENTOR, 2017.**



BASHKIA BERAT

---

**BASHKIA BERAT**

**PROJEKT BUXHETI I VITIT 2018**

**&**

**PBA PERFUNDIMTARE 2018-2020**





## **Përmbajtja e Buxhetit 2018**

### **MESAZHI I KRYETARIT TE BASHKISE BERAT Z. PETRIT SINAJ**

#### **1. Hyrje.**

1.1 Misioni, vizioni dhe Objektivat e buxhetit te vitit 2018.

1.2 Informacion permbedhes per buxhetin e vitit 2018.

#### **2. Financimet e Bashkise Berat per vitin 2018 dhe periudhes afatmesme 2018-2020**

2.1 Transferta e pakushtëzuar 2018.

2.2 Transfertat specifike 2018.

2.3 Transferta të Kushtëzuara per funksione te deleguara.

2.4 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

2.5 Të ardhurat nga taksat dhe tarifate vendore.

2.6 Të ardhurat nga Institucionet e Varësisë.

2.7. Plani financiar i periudhes afatmesme 2018-2020.

#### **3. Parashikimi i shpenzimeve te Bashkise Berat**

3.1 Stuktura Financiare e Buxhetit 2018.

3.2 Planifikimi i nr.te punonjesve dhe shpenzimeve te personelit (paga dhe sigurime shoqërore).

3.3 Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike.

3.4 Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja.

3.5 Shpenzimet për subvencione.

3.6 Transferta tek organizatat dhe individë.

3.7 Fondi rezerve, Fondi i kontigjences, fondi i emergjencave civile.

3.8 Planifikimi i fondit te investimeve.

#### **4. Planifikimi i shpenzimeve sipas programeve te zhvillimit te qytetit**

4.1 Programi i Administrimit të Përgjithshëm.

4.2 Zhvillimit Ekonomik,

4.3 Shërbimet Publike Vendore ( me tre nenprograme, pastrim. gjelberim, menaxhim rrugor & ndicim publik.)

4.4 Programi i Arsimit dhe Edukimit.

4.5 Programi i Kultures, Arteve, Trashegise, Turizmit, Mmarredheniet me Jashte dhe Sporteve.





4.6 Programi i Kujdesit Social.

4.7 Mbrojtja e Mjedisit, Administrimi i Ujrave, Zhvillimi i Bujqesise, Pyjeve lokale dhe Sherbimi Veterinar.

4.8 Planifikimi i Territorit , Investimeve dhe Kontrollit te Projekteve .

4.9 Menaxhimi i Pronave te Bashkise dhe Strehimit.

4.10. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpetimi .

#### **5. Planifikimi i shpenzimeve për Institucionet e Varësisë**

5.1 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

5.2 Ndërmarrja e Gjelberimit.

5.3 Drejtoria e Bujqesise, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe Sherbimit Veterinar.

5.4 Drejtoria Arsimore .

5.5 Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” .

5.6 Qendra “Lira”.

5.7 M Z SH.

#### **6. Pasqyrat analitike te planifikimit te cdo te ardhure per Bashkine dhe Nj. A. Planifikimi i te ardhurave nga drejtorite dhe institucionet e bashkise**





**MESAZHI I KRYETARIT TE BASHKISE BERAT PER BUXHETIN E VITIT 2018  
Z.PETRIT SINAJ**

E nderuar Kryetare e Keshillit te Bashkise Berat, zonja Nikoleta Manka!  
Te nderuar keshilltare!

Kam kenaqesine dhe privilegjin te paraqes sot para Jush, te zgjedhurve vendor, por dhe gjithë bashkeqytetareve te mi, si dhe mbare komunitetit te Bashkise sone projektbuxhetin e vitit 2018 si dhe angazhimet afatmesme 2018-2020 te Bashkise Berat.

Ne nuk po permbushim thjesht nje detyrim ligjor per informim, por ne kete diskutim te hapur mes Jush, te filluar qe muaj me pare, bejme transparencen publike dhe mediatike te te gjithë angazhimit tone profesional dhe moral, ne hartimin e ketij dokumenti, nga me te rendesishmit qe vendimon Keshilli Bashkiak.

Pas dy viteve 2016-2017 te zbatimit te reformes territoriale-administrative, Bashkia Berat eshte me e konsoliduar potencialisht dhe ekonomikisht, duke ju referuar statistikave si ne drejtim te planifikimit te burimeve financiare ashtu dhe te realizimit dhe perdorimit me dobi te tyre.

Ky është viti i parë i zbatimit të ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe me daljen e akteve nënligjore në zbatim të tij, janë hedhur bazat e shendosha të mirëmenaxhimit të financave vendore:

Përmes këtij ligji në vitin 2018 do të arrihet rritja e autonomisë fiskale edhe financiare vendore nëpërmjet ;

- sigurimit të më shumë burimeve të financimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të shoqëruara me më shumë parashikueshmëri, stabilitet dhe transparence.  
Bashkite do te perfitojne nga taksat kombetare:
  - a. 97 % te te ardhurve nga kalimi te se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme per individe, personat fizik dhe juridik;
  - b. 25 % e te ardhurave nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura ( ka qene 18 % )
  - c. 5 % e te ardhurave nga renta minerare.
  - d. 2 % e te ardhurave nga tatimi mbi te ardhurat personale.
- forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale.
- rritja e kompetencave dhe fondeve për qeverisjen vendore në sektorë zhvillimorë si bujqësia, pyjet, rrugët, dhe transformon rrënjësisht konceptin e qeverisjes vendore duke i dhënë një dimension të ri qeverisjes vendore, më shumë mundësi zhvillimi.





## BASHKIA BERAT

---

*Bashkia Berat ka përgatitur këtë dokument duke kaluar të gjitha fazat sipas ligjit nr.68/2017 "Per financat e veteqerisjes vendore".*

Me motivin **"Buxheti nuk është liste dëshirash"** por një plan financiar që balancon burimet financiare të mundshme me nevojat me të domosdoshme e prioritare, gjatë ushtrimit të funksioneve të njesise së qeverisjes vendore të përcaktuara me ligj, Bashkia Berat **ftoi gjithë aktoret të bëhen pjesë e përgatitjes së këtij dokumenti.**

*Ne baze të një plan-veprimi u realizuan degjese të publikë në të katër njesitë administrative dhe lagjet e qytetit. Degjese u organizuan edhe me grupet e interesit, me shoqëri civile dhe me komisionin qytetar. Gjithesëj 9 degjese të publikë.*

*Problematikat e dala nga këto degjese që kishin të bënin kryesisht me infrastrukturën rrugore, rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza, permiresimin e ndicimit, shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta, permiresimin e furnizimit me ujë të pishem, etj. u adresuan në Ndermarrjet, institucionet dhe Drejtorite përkatëse që të jenë pjesë integrale e Plan Buxhetit 2018, si dhe dy viteve pasuese të tij 2019-2020.*

Ne lidhje me hapat e mëtejshme të përgatitjes së plan buxhetit të vitit 2018, gjatë muajve tetor-nentor u punua nga specialistet përkatës të Drejtorive të Bashkisë në planifikimin për çdo zë të ardhurave dhe shpenzimeve, duke arritur të sjellim një buxhet ambicioz në planifikimin e të ardhurave dhe sa më real dhe më afër qytetareve në drejtim të shpenzimeve:

Fokusi i punës sonë në periudhën afatmesme 2018-2020, konsiston në përmbushjen e

### **Qellimit kryesor:**

**Realizimin e investimeve të qëndrueshme për ta kthyer Beratin në një destinacion të rëndësishëm turistik ndërkombëtar, dhe zhvillimin e njesive administrative si pika të rëndësishme të agrobiznesit dhe eko-turizmit.**

Te tjera angazhime të Bashkisë Berat:

### **1.Politika e bashkisë për stëhimin:**

Bashkia Berat edhe në periudhën afatmesme 2018-2020 do të vijoj:

- ✓ Te mbështese projektin e nisur nga ish- Ministria e Zhvillimit Urban për subvencionimin e qirase në tregun e lirë **për familjet e pastreha me të ardhura familjare mujore shumë të ulëta, me persona me aftësi të kufizuar në përbërjen familjare, gratë e divorcuara me fëmijë në ngarkim**, i cili ka filluar në vitin 2017 ku përfitues kanë qënë 7 familje, dhe vlera e subvencionimit është mbuluar nga pjeserisht nga fonde të celura nga ish-M.ZH.U dhe pjeserisht nga fonde nga buxheti i bashkisë.
- ✓ Te përfshije në skemën e përfitimit të subvencionimit të qirasë edhe familjet në kushte të vështira sociale dhe ekonomike të strehuara në banesat sociale të bashkisë.





## BASHKIA BERAT

---

2. Marredheniet me jashte: Fokusi i punes se Bashkise do te jete:

- Bashkefinancimi ne projekte me partnere dhe organizata nderkombetare.
- Perfitimi i granteve te Programeve te Bashkimit European.
- Projekte te perbashketa me Bashkite Binjake.
- Aplikimi me projekte per cdo thirrje financimi nga donatore te mundshem.

Gjatë vitit 2017 janë duke u realizuar:

- ✓ Projekti me Banken Botërore, për financimin e Projektit të Zhvillimit të Turizmit për Shqipërinë e Jugut, pas ratifikimit të Marrëveshjes në Parlamentin Shqiptar, për dy investime të rëndësishme në qytet:

1- Rehabilitimi i rrugës automobilistike “Muzak Topia” për në Kala.

2- Rehabilitimi i rrugës me kalldrëm për këmbësoret “Mihal Komneno” për në Kala.

- ✓ Me Kooperacionin Zvicerian është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit për projektin

“Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane në Rajonin e Beratit”, projekt i cili do të shtrihet në një periudhë kohore 5- vjeçare dhe do të bëjë të mundur studimin për menaxhimin e mbetjeve në gjithë territorin e Rajonit të Beratit dhe ngritjen e një landfilli, i cili do të përpunojë mbetjet e diferencuara .

- ✓ Vazhdon intensivisht puna për rehabilitimin e rrjetit ujësjellës - kanalizime, nëpërmjet kredisë së Bankës Gjermane KFW, investim i cili do të zgjidhë furnizimin me ujë të qytetit të Beratit.
- ✓ Me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, u realizua investimi i rrugës “Naim Frashëri” pranë Sheshit Teodor Muzaka duke mbyllur ciklin e investimeve në Pedonalen e Qytetit
- ✓ Në vitin 2017 - 2018 vijon bashkëpunimi i ngushtë për investime në Qendrën Historike dhe mbështetje për Zonën e Biznesit BID.
- ✓ Prezenca e Agjensisë Amerikane për Zhvillim USAID, në fushën e financave, taksave dhe shërbimet publike për ngritje kapacitetesh dhe logjistikë për stafin e bashkisë. Në vitin 2017 vijoi puna në këta sektorë, duke qenë bashki e përzgjedhur ndër 5 bashkitë pilot të USAID në Shqipëri.
- ✓ Bashkia Berat, në bashkëpunim me Organizatën Franceze të Qyteteve të Artit dhe Historisë, kanë filluar punën për Projektin “Zhvillim i Qëndrueshëm në Lagjen Goricë”. Projekti synon asistencë teknike të ekspertëve Francezë në restaurimin dhe rijetezimin e Lagjes Goricë, me funksion zhvillimin e turizmit kulturor.





## BASHKIA BERAT

- ✓ Vazhdon projekti në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara PNUD, për integrimin social të popullatës romë në qytetin e Beratit dhe mbështetja për Qendrën Komunitare Romë. Ka mbaruar rikonstruksioni i plote i kopshtit Barikada e Re si dhe pajisja me gjithë bazen materiale dhe didaktike. Ka filluar nga puna rikonstruksioni i plote i Cerdhës Nr.7 si dhe rehabilitimi i KUZ rreth Zagores.
- ✓ Në bashkëpunim me organizatën Risi Albania do të bëhet e mundur ngritja e tregut artizanor në Pedonalen e qytetit .
- ✓ Organizata Cesvi, dhe bashkia Berat, do fillojnë implementimin e projektit për turizmin dhe trashëgiminë në qytet. Projekti do të shtrihet në një periudhë 3- vjeçare dhe fokusi i projektit është turizmi rural dhe kulturor, gastronomia si dhe artizanati.
- ✓ Me Kompaninë TAP Shqiperi do të bëhet e mundur rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Veterik dhe ndërtimin e një kopshti për fëmijet në Dyshnik si dhe ndërtimin e shkollës së re në Uznovë. U mundësua mbështetja financiare për mobilimin e brendshëm i Bibliotekës “Vexhi Buharaja” duke bashkëfinancuar edhe bashkia Berat në Shumen prej 2 000 000 leke .
- ✓ Me kompaninë e naftës Shell do të bëhet e mundur mbështetja për disa evente kulturore dhe panairë kulturore në fshatrat përreth Malit Shpirag. Ka mbaruar projekti-pilot për ndërtimin me panele diellore në fshatin Galinë dhe Sadovice, Njësia Administrative Sinje. Ka mbaruar plotësimi me baze materiale dhe didaktike në shkollën 9-vjeçare Mbreshtan si dhe është gati ndërtimi i Qendrës Shëndetësore në Mbreshtan.
- ✓ Në kuadrin e Programit IPA Competitiveness 2017, Beratit do të jete pjesë e financimit nga Delegacioni i BE dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ( BERZH) , për projekte infrastrukturore në funksion të rritjes së turizmit. Bashkia Berat ka aplikuar për mbështetje për disa projekte që rrisin aksesin në Malin e Tomorit dhe Qendrën Historike.

Te nderuar keshilltar!

Plan buxheti I vitit 2018, është një buxhet ambicioz dhe në terma vjetore parashikon një rritje krahasuar me buxhetin e vitit 2017 prej 102.3 milion leke, ose 11.2 %. (pa marrë në konsideratë të ardhurat e trashëguara nga viti 2016 në shumën 78 milion).

**Financat e Bashkisë Berat për vitin 2018 do të mbështeten nga:**

- i. Financimi nga Qeveria nëpërmjet Transfertes së pakushtëzuar që është 8.6 % në shumën se viti 2017,
- ii. Financimi nga Qeveria nëpërmjet transfertave specifike për funksionet shtesë të pushtetit lokal, që është 12.8% në shumën se viti 2017,
- iii. Plani i të ardhurave vendore i cili është 12% më shumë se plani i vitit 2017, në vlerë absolute rritja prej 52 milion leke.

***Bashkia Berat planifikon për vitin 2018, një buxhet prej 1010.1 milionë lekë nga të cilat :***

iv.	1. Transferta e pakushtëzuar	277.1 milionë lekë
v.	2. Transferta specifike për funksionet e deleguara	250.3 milionë lekë







## BASHKIA BERAT

vi. 3. Të ardhurat lokale planifikuar për vitin 2018 482.7 milionë lekë

Bashkia Berat planifikoi ne fillim te vitit 2017, një buxhet prej 907.8 milionë lekë nga të cilat :

vii. 1. Transferta e pakushtëzuar 255.5 milionë lekë  
viii. 2. Transferta specifike për funksionet e deleguara 221.9 milionë lekë  
ix. 3. Të ardhurat lokale planifikuar për vitin 2017 430.4 milionë lekë

**Parashikimi i të ardhurave** është bërë duke u bazuar në potencialin e nivelit të gjenerimit të të ardhurave, pa rritur asnjë nivel takse dhe tarife, përveç atyre të parashikuara në ligj.

**Në total:**

- a. Për vitin 2016, të ardhurat në total janë planifikuar në **shumën 330 milionë lekë**, ose rreth 35 %, kundrejt realizimit të 2015-ës.
- b. Për vitin 2017, të ardhurat në total janë planifikuar në **shumën 430 milion leke** ose rreth **30 %** me shume se viti 2016, ose shtesa në vlerë absolute në shumën **10 milion leke**.
- c. Për vitin 2018 të ardhurat në total janë planifikuar në shumën **482 milion leke** ose **12%** me shume se viti 2017, shtesa në vlerë absolute është në shumën **52 milion leke**.

**Ne planifikimin e shpenzimeve** është arritur të ruajmë ballancimin buxhetor dhe ruajtjen e trendit rritës të shpenzimeve për investime nga fondet e vetë Bashkise:

- i. Në vitin 2014 (para reformes) u planifikua 78.2 milion leke investime ose 17 % e buxhetit.
- ii. Në vitin 2015 u planifikua 74.4 milion leke investime ose 17 % e buxhetit, dhe u realizuan 63.7 milion leke.
- iii. Në vitin 2016 u planifikua 173.2 milion lek investime ose 30 % e buxhetit të vetë bashkise, dhe u realizuan 131.2 milion leke.
- iv. Në vitin 2017 u planifikua 235.4 milion lek investime ose 32.2 % e buxhetit të bashkise.
- v. Në vitin 2018 kemi planifikuar 237.4 milion lek investime ose 31.2 % e buxhetit të vetë bashkise ( grand+ të ardhura).

**Ne terma real rritja e fondit të investimeve nga të ardhurat e Bashkise është 159.2 milion leke, krahasuar me vitin 2014 (Viti para reformes).**

Me plan Buxhetin e vitit 2018 dhe PBA 2018-2020 do të synojmë:

1. Vijimin e kryerjes së shërbimeve publike të pastrimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të deshmëve, mirëmbajtjen e lapidareve, dekorin festiv jo vetëm në qytet, por edhe në njesitë administrative, pjesë të bashkise së re Berat.
2. Mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldremeve, mirëmbajtjen e sistemit të ndricimit me qëllim përmirësimin e





## BASHKIA BERAT

vazhdueshëm të kushteve për komunitetin, ne Lagjet nr. 1 , nr. 2, nr. 3, si dhe ne njesite administrative Roshnik , Otlak , Velabisht , Sinje.

3. Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në Bashkinë Berat dhe njësitë administrative të Bashkisë.
4. Ofrimi i nje shërbimi me cilësor dhe brenda nje kohe sa me te shkurter, ne saje edhe te informatizimit teresor te sistemit te taksave dhe tarifave vendore.
5. Venia ne eficence e Zyres me me nje ndalese, per nje shërbim sa me korrekt dhe ne kohe reale me komunitetin.
6. Clirimin e buxhetit te Bashkise nga detyrimet financiare dhe shpalljen e ofertes se hapur per shitjen e aksioneve per Futboll Klub “Tomori 1923 sh.a”.
7. Menaxhimin e qendrueshem dhe afat gjate te pyjeve dhe kullotave , shtimin e te ardhurave ne buxhetin lokal nga shfrytezimi i burimeve natyrore .
8. Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkerendimi i punes me institucionet qendrore per sistemin e ujrave te larta, te stuhive.
9. Nevojen per investime (Trajtuar ne programin e Planifikimit te Teritorit dhe Investimeve) dhe sigurimin e burimeve te tjera financimi pervec te ardhurave te Bashkise, FZHR, edhe nga donatoret dhe nga partneret nderkombetar.
10. **Rritje te transparencës mbi shpenzime dhe buxhete . Projekti i USAID –Per Planifikim dhe Qeverisje Vendore (PLGP) në bashkëpunim me Institutin Shqiptar te Shkencave (AIS) kanë ideuar dhe finalizuar një platformë me disa instrumente ICT për transparencë mbi shpenzime dhe buxhete të njërive të qeverisjes vendore.**
  - Nën moton Qeverisje Transparente si Qeverisje e Mirë /Open Governance as Good Governance me qëllim rritjen e transparencës, mirëstrukturimin e informacionit, komunikimin e institucioneve me bashkitë dhe krijimin e mjeteve që ndihmojnë në rritjen e njohurive dhe nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje.
  - Rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës dhe aktorëve civil në përdorimin e instrumenteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për transparencë dhe mirëqeverisje.

Te nderuar Keshilltare!

*Programi perfundimtar buxhetor afatmesem 2018-2020, (program I investimeve sipas fushave prioritare), ka pasqyruar ne menyre besnike nevojat e kominitetit dhe fokuson pritshmërine e bashkëqytetarëve tanë, duke zbatuar plotesisht detyrimet qe na ngarkon ligji gjate ushtrimit te funksioneve te Bashkise Berat, si njesi e qeverisjes vendore.*

*Por bashkia Berat me financat e saj, nuk i ploteson dhe realizon dot te gjitha projektet dhe nevojat ne rritje te qytetareve tane per te pasur nje qytet te denje per statusin qe gezon:*

**Ndertimi i Unazes se QYTETIT -**, vijon te mbetet nje prioritet qe duhet pare jo vetem si nevoje, por edhe si emergjence, pasi pervec imazhit negativ qe krijohet nga prezenca e





mjeteve te renda ne nje qytet muze, historik dhe turistik si Berati, krijon veshtiresi dhe trafik te renduar nga qarkullimi i ketyre mjeteve brenda qytetit madje perben dhe rrezik per kembesoret.

Ne kapitujt pauses do te gjeni te detajuar dhe te argumentuar ligjerisht dhe profesionalisht zerat e buxhetit si ne krahun e te ardhurave dhe te shpenzimeve.

#### KONKLUZIONE DHE PERFUNDIME;

1. Plan Buxheti I vitit 2018 eshte hartuar nga Bashkia Berat, mbeshtetur ne gjithe aktet ligjore e nenligjore te ardhura nga Ministria e Financave duke ndjekur ne menyre korrekte fazat e pergatitjes se tij.
2. Plan Buxheti 2018 permban te integruar ne programet buxhetore te tij problematikate e dala nga degjesat publike organizuar per here te pare nga bashkia Berat me procesverbal , me liste pjesemarresish dhe me njoftime ne mediat lokale e te pasqyruara ne faqen zyrtare e rrjetin social te Bashkise.
3. Plan Buxheti 2018 (plani i te ardhurave ) eshte mbeshtetur ne paketen fiskale miratuar me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr. 57 date 28.12.2015 "Per miratimin e sistemit te Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkine Berat" I ndryshuar, me VKB "Per disa shtesa dhe Ndryshime te ketij vendimi", dhe ne legjislacionet perkatese.
4. Plan Buxheti 2018 (plani I shpenzimeve) eshte mbeshtetur ne te njejtin numer punonjesish si ne vitin 2017, duke reflektuar ndryshimet ligjore ne fushen e pagave dhe sigurimeve shoqerore.
5. Plan Buxheti 2018 nuk mbart detyrime te prapambetura, mbeshtetur ne pritshmerine e realizimit te treguesve buxhetit te vitit 2017, te cilin do te mbyllim pa deficit, me perjashtim te faturave te muajit dhjetor 2017.
6. Kemi hartuar nje plan te ardhurash ambicioz me rreth 12 % me shume se plani i vitit 2017 dhe realizimi i tij perben nje nga sfidat me te rendesishme te administrates sone per vitin e ardhshem.
7. Ne plan buxhetin e vitit 2018 nuk jane perfshire te ardhurat e trasheguara nga viti 2017 pasi, rezultati perfundimtar do te dale pas rakordimit te ardhurave dhe shpenzimet te realizuara deri me 31 dhjetor 2017, procedure qe kryhet ne janar 2018 me degen e thesarit. Kjo shume do te miratohet me mbedhjen e keshillit bashkiak te fillim te vitit 2018.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin tuaj te vazhdueshem ne vendimarrjet e deritanishme , te rendesishme ne dobi te zhvillimit te Bashkise sone, jam plotesisht i bindur se do te gjeje mirekuptimin tuaj ne mbeshtetjen e ketij Plan Buxheti , me synimin per te bere me te miren ne sherbim te komunitetit te Bashkise Berat!





BASHKIA BERAT

---

Me rastin e festive te funvitet ju percjelle: Urimet me te mira per ju, familjet tuaja dhe mbare komunitetin e bashkise Berat!

Ju faleminderit!

Me respekt,

Petrit SINAJ

KRYETAR I BASHKISE BERAT






## HYRJE.

I njohur jo vetem per bukurite e tij te rralla dhe te patjetersueshme por edhe per mikepritjen qyteti 2400 vjecar i Beratit ka zgjuar interesin e te gjithe turisteve qe e kane vizituar, vendas dhe te huaj. Lagjet simbolike muzeale “Goricë”, “Mangalem” dhe “Kala” , muzetë, kishat dhe xhamitë janë nga më të vizituarat. Ndërkohë që këtyre vlerave vitet e fundit i janë shtuar dhe atraksioni që ofrojnë sporti i rafting në kanionet e Osumit dhe Parku Kombëtar në malin e Tomorrit. Qyteti i Beratit, gjate periudhes janar-tetor 2017 eshte vizituar nga 68269 vizitor vendas dhe te huaj, shifer me te vertete impresionuese me rreth 14 000 vizitor me shume se e njejta periudhe e vitit 2016. Këtë vit në kalanë e Beratit është aplikuar projekti i biletarisë elektronike, me qëllim të promovojë transparencën , të garantojë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për sitet Shqiptare të Trashëgimisë Kulturore si dhe paraqet mje sherbim financiar modern .

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia dhe turizmi. Ekonomia e qytetit të Beratit mbështet në shërbime.

Njësitë Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë ruajtur karakterin rural. Sektori kryesor i ekonomisë në këto njësi është bujqësia. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona. Gjithashtu dhe blegtoria dhe përpunimi i produkteve të mishit dhe qumshit janë të zhvilluara në këto njësi. Berati është zhvilluar si qëndër rajonale për agrobiznesin,



tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionit gjeografik dhe aksesit me rrugët kombëtare.

### 1.1 VIZIONI DHE MISIONI I BASHKISE BERAT, OBJEKTIVAT E BUXHETIT TE VITIT 2018.

Vizioni i zhvillimit te Bashkise Berat dhe Objektivat sipas Strategjise se Zhvillimit te Qytetit (2010-2020)





## BASHKIA BERAT

*Berati i lashtë, qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore, me një komunitet që i gëzohet zhvillimeve harmonike dhe mundësive të barabarta, një qendër e turizmit ndërkombëtar, me ekonomi dinamike të mbështetur në agrobiznes dhe artizanat të konsoliduar.*

**Objektivi 1:** Qendër Ndërkombëtare e Turizmit Kulturor, mbështetur në turizmin familjar, që ruan dhe zhvillon trashëgiminë e tij unike kulturore, historike dhe arkitekturore.

**Objektivi 2:** Zhvillimi i harmonizuar i një ekonomie konkurruese në tregun rajonal, me biznese kryesisht të agrobiznesit e artizanatit, që zgjerohen e inkurajohen për të pasur diversitet e cilësi.

**Objektivi 3:** Zhvillimi i ekuilibruar i territorit në përputhje me parametrat bashkëkohore mjedisore dhe urbane dhe në harmoni me tiparet specifike të trashëgimisë së qytetit.

**Objektivi 4:** Një jetë sociale cilësore, dinamike dhe gjithëpërfshirëse ku shanset individuale për progres dhe mirëqenie mbështeten e zgjerohen në mënyrë të barabartë.

*Misioni i Qeverisjes Vendore sipas nenit 3 të Ligjit 139/2015, është:*

*Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:*

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;*
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;*
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;*
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;*
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;*
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;*
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera*

**Qellimi i përgjithshëm :** Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial, nëpërmjet shpërndarjes së drejtë të burimeve financiare duke prekur gjithë njesite administrative të bashkisë Berat.

**OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM:** Te garantohet që gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit nga cdo strukturë, të gjitha veprimet e nevojshme që janë kryer janë në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Neni 41 “Buxheti i Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore dhe program buxhetor afatmesëm” i Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, citon: Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjisllacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore.





Bashkia Berat ka hartuar dhe pergatitur kete Buxhet duke u mbeshtetur dhe respektuar aktet ligjore e nenligjore:

- Ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar.
- Ligji nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, I ndryshuar.
- Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin. Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Udhëzimet përkatëse për përgatitjen e Buxhetit.
- Te tjera akte ligjore e nenligjore.

#### ***I. Objektivat e Plan buxheti 2018:***

- ✓ **Maksimizimi i** të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore, duke rritur ndjeshëm ato nëpërmjet shtimit të bazës (nr.) së taksapaguesve dhe jo nëpërmjet rritjes se nivelit të taksimit.
- ✓ **Forcimi i disiplinës fiskale**, duke respektuar rregullat dhe parimet e sanksionuara me ligj ne hartimin, konsultimin, miratimin, zbatimin, raportimin dhe auditimin e buxhetit vendore, duke synuar një menaxhim të shëndoshë financiar.
- ✓ **Evidentimin dhe rregjistrimin real** te cdo taksapaguesi si dhe zbatimin e procedurave efektive për te thjeshtuar marredheniet e tatimpaguesit me administraten tatimore vendore.
- ✓ **Rritjen e cilësisë** së shërbimeve në sektorët prioritarë, shërbime publike, arsim dhe infrastrukturë rrugore ne gjithe territorin e bashkise ne sherbim te permiresimit te jetes se qytetareve.
- ✓ **Vijimin e investimeve** te nisura nga viti 2017 dhe shtimin sasior dhe cilësor të investimeve kapitale ne vitin 2018 me ndikim te drejteperdrejte ne zhvillimin ekonomik te Bashkise.
- ✓ **Rritjen e transparencës** në përdorimin e fondeve publike, dhe mire administrimin e financave publike.
- ✓ **Zbatimin e politikave kombëtare** për përcaktimin e nivelit të pagave;
- ✓ **Ruajtjen e trendit rrites** te raportit midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale ne favor te atyre kapitale;





## BASHKIA BERAT

- ✓ **Shpenzimet e personelit** mbështeten ne nr, e pandryshuar te punonjësve për vitin ne vijim si dhe ne kuadrin ligjor ne fuqi për përlllogaritjen e pagave.
- ✓ **Harmonizimin e kërkesave** te komunitetit te dala nga dëgjesat publike me planet sektoriale te bashkise dhe te ndermarrjeve dhe institucioneve ne vartesi te saj.
- ✓ **Ofrimi i shërbimeve** ne cdo Njësi Administrative në standartet dhe cilësinë e kërkuar.
- ✓ **Listimi i prioriteteve** dhe përfshirja e tyre ne strategjitë lokale, balancim i kërkesave me mundësitë financiare.
- ✓ **Realizimin e investimeve te qendrueshme** per t'a kthyer Beratin ne nje destinacion te rendesishem turistik nderkombetar, dhe zhvillimin e njesive administrative si pika te rendesishme te agrobiznesit dhe eko-turizmit.
- ✓ **Shlyerjen e te gjitha detyrimeve** per investimet ne proces nga viti 2017, dhe fillimin e vitit buxhetor 2018 **pa borxhe** e moskrijim detyrimesh te reja.
- ✓ **Mbështetje te aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive** ne bashkëpunim me donator dhe partner vendas dhe te huaj per te gjallesuar jeten e qytetit.

*Ky projektbuxhet mbeshtetur ne parimin e transparences, parashikueshmerise, gjithepërshirjes, etj, ka shprehur nevojat, kerkesat dhe pritshmërite e bashkëqytetarëve tanë. dhe besojme se është zbatim i përgjegjësive ligjore , detyrimeve dhe angazhimeve të marra përsipër nga Bashkia Berat.*

### 1.2 INFORMACION PERMBLEDHES PER PERGATITJEN E BUXHETIT TE VITIT 2018 DHE PBA 2018-2020.

Me Urdhërin Nr. 349 datë 23.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi per Manaxhimin Strategjik dhe jane krijuar Ekipet e Menaxhimit te Programit për manaxhimin dhe sigurimin e zbatimit të sistemit të planifikimit të integruar në përgatitjen e PBA 2018-2020.

PBA eshte hartuar ne perputhje me standartet bashkekohore si dhe mbeshtetet ne trajnimet e specialisteve te finances, tatim - taksave, sherbimeve publike, urbanistikes, burimeve njerezore, prokurimeve etj. te organizuara nga Ministria e Finances, Ministria e Brendshme, Instituti i Trajnimit te Administrates Publike, USAID-i , Co-Plan, Instituti per Zhvillimin e Habitatit si dhe mbeshtetur ne pervojen pozitive te akumuluar, si dhe te njesive te tjera vendore.

PBA është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe shqetësimeve të drejtpërdrejta të komunitetit, të evidentuara : (pervecse mbeshtetur ne dokumenta stategjik).







- I. Gjatë punës sonë të përditëshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.
- II. Nga takimet e Kryetarit të Bashkisë me qytetarë.
- III. Nga kërkesat dhe ankesat e qytetarëve adresuar administratoreve të lagjeve dhe njesive administrative.
- IV. Nga degjësat publike organizuar pas fazës së parë të përgatitjes së PBA.

**Viti 2018 është viti i parë i PBA 2018-2020, në këtë kontekst kërkesat buxhetore 2018 janë harmonizuar me programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020.**

Ne zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 36, Programi buxhetor afatmesëm vendor, Bashkia Berat përgatiti fazën e parë të Planit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe miratoi draftin në Këshillin Bashkiak me Vendimin nr. 67 date 10.07.2017.

*Për të finalizuar procesin dhe për të përgatitur draftin e rishikuar u hartua dhe u zbatua plani i masave dhe veprimet ku u përcaktuan aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.*

*U aplikuan degjësat publike, konsultimet me komunitetin duke tërhequr mendimet e sygjerimet e tyre.*

Bashkia Berat nga data 02.08.2017 – 30.08.2017 ka zhvilluar dëgjësja publike me lagjet Nr.1.2.3 të Bashkisë Berat, Njësiti administrative Otlak , Sinje, Velabisht, Roshnik, me grupet e interesit, dhe Komisionin Qytetar, duke kryer keto aktivitete:

**Aktiviteti nr. 1 :** Organizimi I degjësave publike me komunitetin në lagjet e qytetit dhe njesite administrative.

**Aktiviteti nr. 2** Organizimi I degjësave publike me grupet e interesit; komisionin qytetar,

**Aktiviteti nr. 3** Zhvillim i degjësave publike me komunitetin në lagjet e qytetit , njesite administrative dhe grupet e interesit:

**Aktiviteti nr. 4** Miratimi i dokumentit të rishikuar të PBA 2018-2020.

1. Përgatitja e materialit të rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, Miratimi në Këshillin Bashkiak brenda 15 shtatorit 2017.
2. Dërgimi i materialit në Ministrinë e Financave, brenda 15 shtatorit 2017.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 74 date 22.09.2017 u miratuan PBA (e rishikuar), Tavanet buxhetore sipas programe për periudhën afatmesme 2018-2020.

Propozimet e tërhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u përcollën njesive shpenzuese të vartësisë së bashkisë për të integruar në programet përkatëse buxhetore, sipas listimit të prioritetëve brenda mundësive financiare.





**Aktiviteti nr. 5** Miratimi i dokumentit perfundimtar te PBA 2018-2020 dhe projektbuxheti vjetor 2018 .

*Dokumentet mbi te cilët është mbështetur hartimi i Programi Buxhetor Afatmesëm dhe buxheti vjetor jene:*

- i. Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkise
- ii. Plani i Investime Kapitale
- iii. Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit
- iv. Strategjitë sektoriale qe janë te lidhura me kompetencat e pushtetit vendor

## **2. FINANCIMET E BASHKISE BERAT PER VITIN 2018**

### **2.1. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2018.**

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2018, bazohet në një formulë të përmirësuar me karakteristikat e mëposhtme:

- E thjeshtë për t’u kuptuar dhe zbatuar;
- E bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të njësive të qeverisjes vendore;
- Garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal;
- Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrative-territoriale;
- Ndarja e grantit bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale dhe rajonale. Formula identifikon nevojat për shpenzime duke u bazuar në: popullsinë relative, dendësinë e popullsisë, numrin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. ekualizimi të kostove, i cili realizohet nëpërmjet komponentit të dendësisë dhe taksave të ndara.ekualizimin e kapacitetit fiskal.


Ekualizimi fiskal bazohet në:

- a) Të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël.
- b) Taksa vjetore e automjeteve të përdorura.
- c) Taksa mbi transferimin e pasurisë, për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë.





Paraqitja Grafike.



Pasqyre permbledhese e transfertave:

000 leke

Vitet	2016	2017	2018	2017/2016	2018/2017
Transferta e pakushtezuar	219,580	255,250	277,104	1.16%	1.09%
Transferta Specifike	219,042	233,867	250,334	1.10%	1.07%
<b>Totali Transfertave</b>	<b>438,622</b>	<b>489,117</b>	<b>527,438</b>	<b>1.13%</b>	<b>1.08%</b>

**2. 3 Transferta të Kushtëzuara per funksione te deleguara.**

Transferta e kushtëzuara në buxhetin e vitit 2018, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara (Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore për QKR, dhe shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen e shërbimit të gjëndjes civile. Këto fonde do të përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë. Per buxhetin e vitit 2018 transferta e kushtezuar qe do akordohet per Bashkine Berat do konfirmohet nga Ministrite e linjes gjate vitit 2018.

***Fonde për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.***

Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë së linjes. Ato ju delegohen njësitë të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmën ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore. Per buxhetin e vitit 2018





## BASHKIA BERAT

---

transferta e kushtezuar qe do akordohet per Bashkine Berat, do konfirmohet nga Ministrite e linjes.

### **2.4 Fondi i Zhvillimit te Rajoneve.**

FZHR eshte nje instrument zhvillimor dhe nje mekanizem financiar konkurues qe mbeshtet politiken kombetare te zhvillimit rajonal dhe vendor. Fondet për mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale për vitin 2018 janë parashikuar në nivelin 7 miliard lekë ne nivel kombetar dhe janë përfshirë në buxhetin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Edhe për vitet 2019 dhe 2020, fondet janë parashikuar në nivelin prej 7 miliard respektivisht. Ashtu sikurse vitet e mëparshme, edhe për vitin 2018, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 3 shtylla:

**Programi “Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”;**

**Programi “Shqipëria dixhitale”;**

**Programi “Mbështetje për Ekonominë dhe Biznesin”.**

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për infrastrukturën vendore i papërdorur në fund të vitit 2017, mund të mbartet në vitin 2018, me miratim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, por jo më vonë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2018.

Per vitin 2018 Fondi per Zhvillimin e rajoneve perbehet nga 6 Grande konkuruese specifikesht:

1. Grand per infrastrukturen evendore dhe rajonale.
2. Grand per arsimin.
3. Grand per shendetetsine.
4. Grand per artin dhe kulturen
5. Grand per ujesjelles-kanalizimet.
6. Grand per rehabilitimin mjedisor, gjelberimin dhe pyllezimin.

### **REALIZIMIT TË PLANIT TË TË ARDHURAVE TË VITIT 2017 , DHE PLANIT TË TË ARDHURAVE 2018**

- Në total, për vitin 2017, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Berat përfshirë dhe njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Velabisht dhe Otlak, priten të realizohen në shumën 362,320,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 430,427,000 lekë ose 84%.
- Në total kundrejt realizimit faktik të vitit 2016 prej 277,692,000 lekë të ardhurat e vitit 2017 priten të realizohen me +84,628,000 lekë ose +30% më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Pra përfshirja e njërive administrative në territorin e Bashkisë Berat ka dhënë efekte pozitive në të ardhura, megjithëse kontributi i tyre është i vogël krahasur me të ardhurat e grumbulluara nga bashkia qëndër.





## BASHKIA BERAT

		Fakti 2016	Plan 2017	Fakti 10 Mujor 2017	I pritsh mi 2017	Realizimi % 2017	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel, te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale.	8,104	10,143	3,829	4,500	44%	6,761	6,964	7,173
II	<b>Taksat vendore</b>	<b>144,016</b>	<b>166,320</b>	<b>202,337</b>	<b>213,380</b>	<b>128%</b>	<b>236,538</b>	<b>243,634</b>	<b>250,943</b>
1	Takse tabelle	8,331	8,843	7,832	8,800	100%	8,843	9,108	9,382
•	Tabelë për qëllime identifikimi	5,626	6664	5,773	6,000	90%	6,455	6,649	6,848
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,705	2,179	2,059	2,800	128%	2,388	2,460	2,533
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	16,028	14,533	11,446	13,000	89%	14,533	14,969	15,418
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	24,784	30,000	71,468	72,000	240%	70,000	72,100	74,263
4	Takse fjetje ne hotel	2,973	2,869	4,167	4,600	160%	4,642	4,781	4,925
5	Takse mbi token bujqesore	13,282	18,406	24,531	26,000	141%	27,391	28,213	29,059
6	Takse e mjeteve te perdorura	19,794	20,510	16,096	19,950	97%	27,032	27,843	28,678
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë	2,250	3,000	2,449	2,500	83%	3,200	3,296	3,395
8	Takse mbi ndertesat	49,407	59,134	57,441	59,000	100%	71,366	73,507	75,712
•	Biznes		49,990			0%	59,422	61,205	63,041
•	Familje		9,144			0%	11,944	12,302	12,671
9	Takse Trualli	7,140	8,010	6,892	7,500	94%	9,511	9,797	10,090
10	Te tjera taksa lokale	27	1,015	15	30	3%	20	21	21
III	<b>Tarifat vendore</b>	<b>105,098</b>	<b>111,846</b>	<b>101,627</b>	<b>109,470</b>	<b>98%</b>	<b>128,637</b>	<b>132,496</b>	<b>136,471</b>
1	Tarife e pastrimit	58,282	65,380	63,150	65,000	99%	76,441	78,734	81,096
•	Biznes		41,697			0%	48,317	49,767	51,260
•	Familje		23,683			0%	28,124	28,968	29,837
2	Tarife e ndriçimit publik	23,162	25,576	22,961	25,000	98%	28,420	29,272	30,151
•	Biznes		8,858			0%	9,860	10,156	10,461
•	Familje		16,718			0%	18,560	19,116	19,690
3	Tarife gjelberimi publik	11,274	13,371	11,720	13,000	97%	14,700	15,141	15,595
•	Biznes		6,228			0%	6,693	6,894	7,101
•	Familje		7,143			0%	8,007	8,247	8,494
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	2,678	1,240	1,898	2,800	226%	2,067	2,129	2,193
5	Tarifa urbanistike	130	300	334	350	117%	969	998	1,028
6	Tarifa te sherbimit administrativ	1,543	700	16	20	3%	905	932	960
7	Tarife per, license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	1,295	1,900	1,286	1,300	68%	300	309	318





BASHKIA BERAT

8	Tarifa per zenien e sallave dhe celje kartele lexuesi	158	275		-	0%	275	283	292
9	Tarifa te sherbimit te varrimit	6,103			-		-	0	0
10	Tarife per lende drusore	11	1,995	23	1,700	85%	1,750	1,803	1,857
11	Tarife uji i pijshem(Ujitje)	261	50		-	0%	1,800	1,854	1,910
12	Tarife therje	201	365	239	300	82%	570	587	605
13	Te tjera tarifa		695		-	0%	440	453	467
<b>IV</b>	<b>Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimut</b>	<b>10,292</b>	<b>12,400</b>	<b>9,376</b>	<b>11,400</b>	<b>92%</b>	<b>25,338</b>	<b>26,098</b>	<b>26,881</b>
1	Te ardhura nga konviktet	876	1,200	259	900	75%	1,446	1,489	1,534
2	Te ardhura nga cerdhet	3,254	4,000	3,098	3,500	88%	6,600	6,798	7,002
3	Te ardhura nga kopshtet	6,162	7,200	6,019	7,000	97%	17,292	17,811	18,345
<b>V</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>10,182</b>	<b>123,718</b>	<b>11,797</b>	<b>23,570</b>	<b>19%</b>	<b>79,451</b>	<b>81,835</b>	<b>84,290</b>
1	Te ardhura nga parkimi	2,746	1,923	2,409	2,900	151%	2,326	2,396	2,468
2	Te ardhura nga qerate	2,967	104,363	1,391	11,540	11%	49,491	50,976	52,505
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	3,569	1,400	1,600	2,500	179%	5,234	5,391	5,553
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	876	1,000		-	0%	-	0	0
5	Te ardhura nga biletat		0	117	130		-	0	0
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	24	15,032	6,280	6,500	43%	22,400	23,072	23,764
<b>VI</b>	<b>Te ardhura nga legalizimet</b>		<b>6,000</b>			<b>0%</b>	<b>6,000</b>	<b>6,180</b>	<b>6,365</b>
<b>TOTALI</b>		<b>277,692</b>	<b>430,427</b>	<b>328,966</b>	<b>362,320</b>	<b>84%</b>	<b>482,725</b>	<b>497,207</b>	<b>512,123</b>

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2017 pritet të realizohet në masën 84 %, me një mosrealizim në shumën 68,107,000 lekë (te ardhurat nga qerate ,se bashku me te ardhurat nga legalizimet). Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë 2 zëra të të ardhurave të cilët në total kanë një efekt në mosrealizimin e të ardhurave me rreth -68.107.000 lekë ose – 16 % të planit të të ardhurave totale të vitit 2017.

- **Mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël,**kjo per arsye se ka pasur ndryshime ne legjislacion ,duke u ndryshuar kategorizimi per tatimpaguesit ne baze te qarkullimit.Subjektet me qarkullim nga 0 deri ne 5(pese) milion leke ne vit ,niveli i kesaj takse eshte 0(zero) leke.

- **Mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga qerate,**kjo per arsye se ne kete ze per vitin 2017 u planifikua te ardhura nga shfrytezimi i pronave te bashkise per karierat e gurit.Bizneset u njoftuan nga Drejtoria e Menaxhimit te Pronave me gjithe procedurat e nevojshme ,por asnje reagim nga ana e tyre deri tani.

- **Mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga legalizimet,** të ardhura të cilat mbliidhen nga A.L.U.I.Z.N.I. është në nivele shumë të ulëta në këto 5 vjet radhazi.Efektij në të ardhurat e Bashkisë nga mosrealizimi i të ardhurave nga legalizimet është rreth - 6,000,000 lekë.





**-Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga taksa e kalimit te se drejtes se pronsisë, të ardhura të cilat mbliidhen kryesisht nga ZRPP,dhe bashkia perfiton nje % te caktuar me transferte. Efekti në të ardhurat e Bashkisë nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksa e kalimit te se drejtes se pronsise, është rreth - 500,000 lekë.**

**Pasqyra nr. 3**

**Ecuria në vite e të ardhurave nga taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël në /000 lekë**

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa+Tatimi	41,667	55,309	53,640	49,740	51,892	45,839	41,649	34,615	45,856	8,104	4,500

Ndjekja e këtij tatimi i kaloi Drejtorive Rajonale Tatimore në rolin e agjentëve tatimorë, shërbim për të cilin përfitojnë 1% të vlerës së arkëtuar. Shihet se, realizimi i të ardhurave nga ky zë është më i ulët në raport me të ardhurat në vitet e mëparshme, kur këto të ardhura mbliidheshin nga Bashkia Berat. Madje në këtë drejtim janë bërë hapa pas, pasi edhe duke arkëtuar të ardhura nga një numër më i madh biznesesh (si rezultat i rritjes së numrit të bizneseve të regjistruar dhe përfshirjes së subjekteve të katër njësive administrative) të ardhurat e mbledhura nga agjenti tatimor nuk arrijnë dot të ardhurat kur ky tatim administrohej nga strukturat e bashkisë.Gjithashtu u ndryshua kategorizimi per tatimpaguesit ne baze te qarkullimit.Subjektet me qarkullim nga 0 deri ne 5(pese) milion leke ne vit ,niveli i kesaj takse eshte 0(zero) leke.

Në total të ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël :

- Për vitin 2017 priten të realizohen në shumën 4,500,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 10,143,000 lekë ose 44 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2016 prej 8,104,000 lekë të ardhurat e vitit 2017 priten të realizohen me -3,604,000 lekë më pak se realizimi i vitit të kaluar.

Një efekt të konsiderueshëm ka fakti se subjektet kanë paguar në nivelin minimal të përcaktuar. Shumica e tatimpaguesve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël i përkasin kategorisë së xhiros deri në 2 milion lekë. Shumë pak tatimpagues e kalojnë këtë prag.

Për vitin 2016 me ndryshimet që i janë bërë ligjit nr.9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” tatimpaguesit me xhiro deri në 5 milion lekë përjashtohen nga pagesa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Gjithashtu ulet me 2.5% tatimi për subjektet me xhiro 5 deri në 8 milionë lekë/vit si dhe hiqet pragu minimal i pagesës së tatimit nga tatimpaguesit prej 25 mijë lekë/vit. Si rrjedhojë, efektet financiare për buxhetin e bashkisë Berat nga heqja e këtij tatimi janë tejet të rënda, pasi ky tatim është ndër zërat kryesore të buxhetit të bashkisë sonë.

Sic e kemi theksuar, nevojitet që agjenti tatimor të ushtrojë kontrole të imtësishme të pasqyrave financiare të paraqitura nga këto kategori biznesesh, gjë e cila duhet të reflektohet në rritje të të ardhurave që duhet ti kalojnë Bashkisë Berat.

Grafikisht paraqesim të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël si dhe nga taksa vendore mbi biznesi i vogël ( në kohën kjo taksë ekzistonte).






## BASHKIA BERAT

Grafiku nr. 3

Ecuria në vite e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe taksa vendore mbi biznesin e vogël



a. Të ardhurat nga taksat vendore

Kryesisht këto të ardhura mbliidhen nga Bashkia Berat si dhe nga agjentët tatimorë.

- Të ardhurat nga taksat vendore për vitin 2017 priten të realizohen në shumën 213,380,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 166,320,000 lekë ose 128 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2016 prej 144,016,000 lekë të ardhurat e vitit priten të realizohen me +69,364,000 lekë ose +48 % më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa mbi ndërtesat, mbi truallin, Takse e tabeles, Takse fjetje ne hotel, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike, taksa mbi token bujqesore, taksa e mjeteve të përdorura, taksa mbi ndërtesat dhe truallit. Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa mbi ndërtesën që arkëtohet nga biznesi, e cila në pesë vitet e fundit shënon rritje nga njëri vit në tjetrin, taksa e ndikimit ne infrastrukture, taksa e mjeteve të përdorura, taksa e fjetjes në hotel dhe përgjithësisht të ardhurat nga taksat e ndërteses dhe truallit.

Për zërat e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore , taksat mbi ndërtesat (si për familjet ashtu edhe për biznesin), taksa e ndikimit ne infrastrukture, arkëtimi i vitit 2017 është në nivelin më të lartë që është realizuar gjatë periudhës 2005-2016. Realizimi ne nivel te larte i takses mbi token bujqësore dhe takses mbi ndërtesat, eshte merite e punes se vazhdueshme e Drejtorise se Taksave.

Efektin dominues në mosrealizimin e të ardhurave nga taksat vendore e ka mosrealizimi i të ardhurave nga taksa e kalimit te se drejtes se pronsise dhe nga taksa per zenien e hapsires publike.

Pasqyra nr. 4

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore në /000 lekë

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksat	48,529	55,396	85,395	73,565	74,966	65,146	63,867	70,361	88,895	141,325	213,380







## BASHKIA BERAT


vendore										
---------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga taksat vendore. Viti aktual 2017 shënon pikën maksimale të arkëtimeve nga taksat vendore.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku nr. 4

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore



#### **b. Të ardhurat nga tarifat vendore**

Kryesisht këto tarifa mblihen nga Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, nga Njësitë administrative dhe agjenti tatimor sh.a Ujësjiellës Kanalizime Berat – Kucovë.

- Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2017 priten të realizohen në shumën 109,470,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 111,846,000 lekë ose 98 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2016 prej 105,098,000 lekë të ardhurat e vitit 2017 janë realizuar me +4,372,000 lekë ose + 4 % më shume se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndricimit, gjelbërimit që mblihen nga biznesi dhe nga familjet

Gjithashtu kete vit kemi dhe nje rritje ne realizimin e tarifes se regjistrimit te biznesit, duke pasur parasysh dhe shfrytezuar nga administrata tatimore informacionin e marre nga qkb, per regjistrimet e reja.

Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel shumë të mirë realizimi.

Përveç realizimit në nivel shumë të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm.





## BASHKIA BERAT

Nivel shumë të mirë realizimi shënoi edhe tarifa e regjistrimit për subjektet e rinj të biznesit që tregon punë të mirë të kryer në drejtim të uljes së informalitetit, por që duhen shfrytëzuar të gjitha potencialet në drejtim të regjistrimit të subjekteve që u shmangen detyrimeve tatimore.

Realizim shumë të mirë kanë edhe të ardhurat nga tarifatat e institucioneve shtetërore.

Theksojmë se Bashkia Berat i ka kushtuar vëmendje maksimale arkëtimit të të ardhurave nga tarifatat e familjës. Nëpërmjet futjes së këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm është zgjeruar baza e tatimpaguesve dhe ka sjellë rezultate pozitive në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu ndaj cdo qytetari, i cili kërkon që ti ofrohet një shërbim i caktuar administrativ nga bashkia, kërkohet që ai të paraqesë librezën e taksave ku të ketë likuiduar taksat dhe tarifatat vendore.

Në drejtim të rritjes së të të ardhurave nga familjet kemi kërkuar edhe mbështetjen e gjithë drejtorive rajonale për pagesën e detyrimeve të punonjësve të tyre, por që nuk kemi gjetur mbështetje në të gjitha këto struktura.

### Pasqyra nr. 5

**Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifatat vendore** në /000 lekë


Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifatat vendore	31,387	35,334	52,489	36,369	35,599	35,816	40,857	70,361	82,156	103,700	109,470

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se pothuajse gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga tarifatat vendore. Viti 2017 shënon pikën maksimale të arkëtimit nga tarifatat vendore.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga tarifatat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku nr. 5

**Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifatat vendore**



### c. Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit

Këto tarifa mblidhen nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit





## BASHKIA BERAT

- Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit për vitin 2017 priten të realizohen në shumën 11,400,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 12,400,000 lekë ose 92 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2016 prej 10,292,000 lekë të ardhurat e vitit 2017 priten të realizohen me +1,108,000 lekë ose përafërsisht në të njëjtën përqindje sa realizimi i vitit të kaluar.

### Pasqyra nr. 6

Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit - në /000 lekë


Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhura nga D.E.A	15,900	8,704	8,864	10,568	10,908	9,657	9,239	10,204	10,249	10,292	11,400

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se në 5 vitet e fundit nuk kemi luhatje të mëdha të arkëtimit të të ardhurave nga ky zë.

Viti 2007 shënon pikën maksimale të arkëtimit nga të ardhurat e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit. Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga kjo Drejtori shihet në grafikun e mëposhtëm

### Grafiku nr. 6

Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit



### Te ardhurat e tjera

Këto të ardhura mbliidhen nga Drejtoritë e Bashkisë si dhe nga ndërmarjet e varësisë.

- Të ardhurat e tjera për vitin 2017 priten të realizohen në shumën 23,570,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 123,718,000 lekë ose 19 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2016 prej 10,182,000 lekë të ardhurat e vitit 2017 priten të realizohen me +13,388,000 lekë më shume së realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë të ardhurat nga të ardhurat nga qëratë nga ndërtesat dhe pajisjet, të ardhurat nga parkimi, të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera.

Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin të ardhurat nga gjobat kamatvonesat dhe të ardhurat nga parkimi.





## BASHKIA BERAT

### Pasqyra nr. 7


#### Ecuria në vite e të ardhurave të tjera në /000 lekë

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhura të tjera	5,793	2,746	3,254	7,611	8,882	9,973	29,244	12,541	11,015	20,023	23,570

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se kemi luhatje të arkëtimit të të ardhurave nga ky zë. Lulatjet në këtë zë janë më të mëdha për faktin se shpesh herë gjatë viteve nënzhërat e këtij grupi janë rikonfiguruar si pjesë e grupeve të tjera të të ardhurave. Megjithatë është për tu theksuar fakti se nga viti 2008 dhe në vazhdim vazhdon trendi rrites i të ardhurave të tjera. Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku nr. 7

#### Ecuria në vite e të ardhurave të tjera



#### **d. Të ardhurat nga legalizimet**

Këto të ardhura mbliidhen nga agjenti A.L.U.I.Z.N.I, por kete vit, pritet me mosrealizim.

### Pasqyra nr. 8

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga legalizimet në /000 lekë

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Te ardhurat nga legalizimet	-	2,221	22,073	4,024	3,998	1,555	1,569	10	-	-	-

Viti 2014 shënon pikën minimale të arkëtimit nga të ardhurat nga legalizimet. Karakteristikë është fakti se pas vitit 2009, vit pas viti të ardhurat nga ky zë po shënojnë rënie. Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.


### Grafiku nr. 8

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga legalizimet





## BASHKIA BERAT



### A. PLANI I TË ARDHURAVE

#### a. Te ardhurat lokale

Pranë Bashkisë Berat në kuadër të hartimit të planit të të ardhurave, pjesë përbërëse e Buxhetit të vitit 2018, është ngritur Grupi i Manxhimit Strategjik.

Si çdo vit planifikimi i të ardhurave të vitit 2018 është kryer në mënyrë analitike, duke ju referuar cdo takse dhe tarife vendore, të cilat analizohen në hollësi. Cdo e ardhur është planifikuar në bashkëpunim me punonjësit të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejtë në punën e tyre me arkëtimet nga taksat dhe tarifat vendore. Këtu bën pjesë gjithë stafi i Drejtorisë së Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, stafi njësisive administrative Roshnik, Sinjë, Otlak, Velabisht ashtu edhe stafi i Drejtorive të tjera të Bashkisë Berat që krijojnë te ardhura.

Viti 2018 është viti i trete që planifikojmë të ardhurat e Bashkisë “së madhe” Berat në të cilën përfshihet një territor më i gjërë. Natyrisht që një planifikim i tillë paraqet akoma shumë veshtirësi kjo për faktin se 4 njësitë administrative kanë burime financiare tepër të kufizuara.

Gjithashtu paraqet shumë veshtirësi mbulimi i shpenzimeve të këtyre njësisive me të ardhurat që ato vetë do realizojnë. Si rrjedhojë shpenzimet e tyre do mbulohen nga të ardhurat që do sigurojë Bashkia Qëndër.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2018 mbështetet kryesisht në :

- Reflektimin e politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2017, me ndryshimet përkatëse.
- Ruajtjen e qëndrueshmërisë të nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.
- Realizimin faktik të ardhurave të vitit 2016-2017.
- Parashikimin e të ardhurave nga agjentët tatimorë,
- Thellimin e vazhdueshëm të punës në drejtim të evidentimit dhe regjistrimit të subjekteve të paregjistruar në organet tatimore.

Për vitin 2018 të ardhurat totale parashikohen në shumën 549,580,000 leke. Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat nga legalizimet si dhe të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar sipas tabelës së mëposhtme :





## BASHKIA BERAT

Emertimi	Plani 2017	Plan 2018
Totali i Të ardhurave	430 217,000	482,729
<b>TOTALI</b>	<b>430.217.000</b>	<b>782.729.000</b>

### RISITË DHE RISQET QË PRITEN TË NA SHOQËROJNË GJATË VITIT TË ARDHSHEM 2018 TË CILAT DO TË NDIKOJNË TË ARDHURAT E BASHKISË

#### RISITË :

- Në vazhdimësi ,permiresimi i sherbimit ndaj tatimpaguesve si rrjedhoje e shtrirjes në njësitë administrative dhe zyrat e taksave ku paguhen taksat e familjes te sistemit bashkëkohor informatik tatimor TAIS per administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Kjo do të sjellë uljen e kohës së shërbimit ndaj tatimpaguesve dhe ulje të punës manuale të specialistëve.
- Në kuadër të reformës teritoriale zgjerimi i vijës administrative të Bashkisë Berat, duke shfrytëzuar rritjen e bazeve se taksueshme,dhe evidentimin e metodave te reja.
- Shtohet lehtësirat tatimore per biznesin gjate vitit 2017dhe konkretisht:
  - Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja,dhe te drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit ,për të gjitha Njësitë Administrative ,kjo tarifë paguhet ne 20% me ulët te tarifës normale.
  - Për Familjet me një prind ,me fëmijë deri në moshën 22 vjec,që janë në vazhdimësi të arsimimit, per të gjitha Njësitë Administrative .kjo tarife paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.
- U ndryshua Tarifa e Pastrimit dhe largimit te mbeturinave Per subjektet e biznesit te madh, që nxjerrin gurin ranor,etj,dhe perpunimin e tyre,per cdo njësi administrative,qe ka sjelle ndryshim ne te ardhura.
- U shtua Tarifa e sherbimit per kryerjen e procedures se kalimit te pronesisë te pasurive te paluajtshme,të ndertuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedon akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre .
- Për familjet në nevojë tarifa e shërbimit për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedon akte fitimi pronësie , kjo tarifë paguhet ne 50% me ulët te tarifës normale.

Në total, për vitin 2018, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë planifikuar në shumën 482,725,000 lekë. Kundrejt realizimit të pritshëm të vitit 2017 në shumën 362,320,000 lekë të ardhurat e vitit 2018 janë planifikuar +120,405,000 lekë ose +30% më shumë.





Bashkia Qëndër planifikon të arkëtojë 397,809,000 lekë ose 82 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Roshnik planifikon të arkëtojë 8,368,000 lekë ose 2 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Sinjë planifikon të arkëtojë 9,579,000 lekë ose 2 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Otlak planifikon të arkëtojë 33,992,000 lekë ose 7 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Velabisht planifikon të arkëtojë 20,217,000 lekë ose 4 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Nga agjentët tatimore planifikohen të arkëtohen 42,993,000 lekë ose 9 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi planifikimin e të ardhurave të vitit 2018 sipas grupeve kryesore :

Emërtimi	Plani 2018	Në /000 lekë
		Struktura (në %)
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	4,000	1
Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	2,761	1
Të ardhura nga taksat vendore	236,538	49
Të ardhura nga tarifrat vendore	128,637	27
Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit	25,338	5
Të ardhura të tjera	76,425	16
Të ardhura nga legalizimet	6,000	1
<b>TOTALI</b>	<b>482,725</b>	<b>100 %</b>

Peshën kryesore të rritjes së planit të të ardhurave të vitit 2018 në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2017 e kanë të ardhurat nga taksat vendore në vlerën +23,158,000 lekë, rritje e cila vjen si rrjedhojë e planifikimit të ardhurave për tu realizuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, takse fjetje në hotel, taksa mbi tokën bujqësore, takse nga mjetet e përdorura si dhe nga efektet e ndryshimeve në paketën fiskale në taksën e ndërtesës dhe tabeles.





BASHKIA BERAT

PLANI FINANCIAR I BASHKISE BERAT PER PERIUDHEN AFATMESME 2018-2020.

Nr.	Pershkrimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
<b>I</b>	<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>997,993</b>	<b>1,010,163</b>	<b>1,039,608</b>	<b>1,061,242</b>
<i>1</i>	<i>Total Transferta</i>	<i>546,586</i>	<i>527,438</i>	<i>542,401</i>	<i>549,119</i>
a	Transferta e pakushtezuar	255,250	277,104	292,067	298,785
b	Transferta e pakushtezuar trashëguar nga viti paraardhës	21,206			
c	Transferta Specifike	233,868	250,334	250,334	250,334
d	Transferta e Specifike trashëguar nga viti paraardhës	36,262			
<i>2</i>	<i>Total te ardhura te veta</i>	<i>451,407</i>	<i>482,725</i>	<i>497,207</i>	<i>512,123</i>
a	Te ardhura te veta	430,427	482,725	497,207	512,123
b	Te ardhura te veta trashëguar nga viti paraardhës	20,980			
<b>II</b>	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>997,993</b>	<b>1,010,163</b>	<b>1,039,608</b>	<b>1,061,242</b>
<b>1</b>	<b>Totali shpenzime operative</b>	<b>762,604</b>	<b>772,743</b>	<b>793,538</b>	<b>804,363</b>
a	Shpenzime personeli	461,216	492,568	495,831	505,017
b	Shpenzime operative	301,388	280,175	297,706	299,345
<b>2</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>235,389</b>	<b>237,420</b>	<b>246,070</b>	<b>256,879</b>

Parashikimi i treguesve ekonomiko-financiar per periudhen 2018 -2020 eshte mbeshtetur ne kriteret e percaktuar ne Udhëzimin e Ministrit te Financave nr. 10/1 date 28 .02.2017 “Per pergatitjen e buxhetit vendor”, si dhe Udhëzimi plotësues nr.10/2 dt.13.07.2017, duke perlllogatitur Transferten e Pakushtezuar si dhe Totalin e te ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore e te Ardhura te tjera.

Totali i te ardhura se bashku me transferten e pakushtezuar dhe transferten specifike do te mbulojne funksione e veta, te perbashketa e te deleguara, te cilat i ushtron njesia e qeverisjes vendore deri ne vitin 2017. Sipas udhezimit te mesiperme :

- o Per vitin 2018 eshte parashikuar 5 % me e larte se ajo e vitit 2017
- o Per vitin 2019 eshte parashikuar 5.4 % me e larte se ajo e vitit 2018
- o Per vitin 2020 eshte parashikuar 10.3% me e larte se ajo e vitit 2019

**Theksojme se qellimi i kesaj PBA-je eshte prezantimi i strategjive apo politikave te Bashkise me terma financiar dhe tendencat e mundshme te te ardhurave dhe shpenzimeve, nisur nga situatat actual.**







### STRUKTURA FINANCIARE E BUXHETIT PER VITIN 2018

**PLAN BUXHETI 2017:** Bashkia Berat planifikoi per vitin 2017, një buxhet prej 907.8 milionë lekë, te cilin e miratoi me VKB nr.115 date 23.12.2016, qe perbehet nga :

1. Transferta e pakushtëzuar 255.5 milionë lekë
2. Transferta specifike për funksionet e deleguara 221.9 milionë lekë
3. Të ardhurat lokale planifikuar për vitin 2017 430.4 milionë lekë

**Buxheti i vete bashkise eshte 685.9 milion leke (Pa transferen specifike)**


**PLAN BUXHETI 2018:** Bashkia Berat planifikon per vitin 2018, një buxhet prej 1010.1 milionë lekë nga të cilat :

1. Transferta e pakushtëzuar 277.1 milionë lekë
2. Transferta specifike për funksionet e deleguara 250.3 milionë lekë
3. Të ardhurat lokale planifikuar për vitin 2018 482.7 milionë lekë

**Buxheti i vete bashkise eshte 759.8 milion leke ,10.8% me i larte se buxheti i vet bashkise ne vitin 2017.**

**Total buxheti i vitit 2018 eshte 11.2% me shume se ai i vitit 2017, ne vlere absolute rritja prej 102.3 milion leke.**

Paraqitja grafike e buxhtit 2017/2018 sipas burimeve te financimit :



Plan buxheti i vitit 2018 eshte i balancuar. Ne mbeshtetje te Udhezimit te Ministrit te Financave nr.2 date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", buxheti vendor eshte unik, te ardhurat dhe shpenzimet parashikohem per cdo ze te tyre, pavaresisht nga burimet e financimit. Struktura e tij eshte e plote, per te gjithë elementet, si ne krahun e te ardhurave dhe ne ate te shpenzimeve.





## BASHKIA BERAT


Mbeshtetur ne pervojen e viteve te meparshme, ky buxhet eshte i detajuar deri ne llogarite analitike, per cdo ze te ardhure dhe cdo ze shpenzimi.

### Buxheti i vitit 2018 perbehet nga:


Ne 000/leke

<b>A - Te ardhurat gjithsej (I +II).....</b>	<b>1 010 163</b>
I - Te ardhurat e buxhetit te pavarur.....	482 724
- Te ardhurat Lokale (Plan i vitit 2018).....	482 724
II - Transferta gjithsej.....	527 439
- Transferta e pa kushtezuar .....	277 104
- Transferta specifike.....	250 334
<b>B - Shpenzimet gjithsej.....</b>	<b>1 010 163</b>
I-Shpenzime korrente nga Burime e veta.....	522 409
II-Shpenzime per funksionet specifike .....	250 334
III - Investime gjithsej (Teprica neto operative)....	237 420
Nga te ardhurat e Bashkise .....	237 420

### Struktura financiare e te ardhurave per vitin 2018



### Struktura financiare e shpenzimeve per vitin 2018





## BASHKIA BERAT

funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativ të njësive të qeverisjes vendore “ ndryshuar me VKM nr. 177 datë 8.03.2017.

Shpenzimet e personelit (600+601), mbeshtet ne nr, e pandyshuar te punonjesve per tre vitet ne vijim si dhe ne kuadrin ligjor ne fuqi perperllogaritjen e pagave ne zbatim te Vendimit te Keshillit Bashkiak nr. 24 date 30.03.2017 “Mbi miratimin e nivelit te pagave te punonjësve te bashkise, njësive vartëse dhe shpërblimin e kryetareve te fshatrave”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me nr. 455/1 prot. date 07.04.2017 “Për verifikim te ligjshmërisë se akteve”, dhe VKB nr.42 date 28.04.2017.

Keto shpenzime do te zene rreth 47 % te totalit te shpenzimeve vjetore, duke ruajtur te njejtin trend rrites rreth 3%, per vitete pauses.

- i. Fondi I pagave per Bashkine dhe Ndermarrjet e Vartesisë, eshte ne shumen 281 335 000 leke dhe ze 37% te totalit te buxhetit te vete, pa perfshire transfertin specifik.
- ii. Fondi I pagave per Bashkine dhe Ndermarrjet e Vartesisë se bashku funksionet e financuara nga transfertat specifikë ne Shumen 482 096 000 leke ze 47% te totalit te buxhetit te vete.

### FONDI I PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQERORE NE DINAMIKE

000/leke

Fakt 2016	I pritshmi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
368 466	461216	482 096	493771	508584

Për vitin 2017 numri maksimal i punonjesve ishte 670 ( miratuar me vendimin nr. 109 datë 25.11.2016 te K B )

Edhe për vitin 2018 numri maksimal i punonjesve ishte 670, nga te cilet ;395 mbulohen nga fondet e bashkise dhe 275 nga Transferta specifikë.

Numri i punonjësve të Aparatit te Bashkisë Berat dhe njësive në vartësi të saj





## BASHKIA BERAT

Emertimi	V. 2017	V.2018	F.të Bashkisë	Trasferta specifike
Aparati i Bashkisë	148	148	148	
<b>Drejtoria e Arsimit,Bashkia Berat</b> Drejtoria 44 punonjes Çerdhe 33 punonjes Konvikti i shk mesme 14 punonjes	91	91	77	14 (Shërbime Mbështetëse arsimit i mesem, konviktet)
M.Z.SH	37	37	6	31
Drejtoria e Bujqësisë , Administrimit të Pyjeve ,Ujërave dhe Shërbimit Veterinar	31	31	21	10
Ndermarrja e Shërbimeve Publike	65	65	61	4
Ndermarrja e Gjelbërimit	58	58	58	
Qendra Kulturorë "Margarita Tutulani	24	24	24	
Qendra "Lira "	22	22		22
Arsimi Parashkollor(educatore,qkf)	114	114		114
Shërbimet Mbështetëse arsimit baze,9 vjecar	80	80		80
<b>Totali gjithsej</b>	<b>670</b>	<b>670</b>	<b>395</b>	<b>275</b>

Me fonde të deleguara, (që nuk përfshihen në nr. e përgjithshëm) janë:

- Gjendja civile 10 punonjës
- Qendra Kombëtare Biznesit (QKB) 3 punonjës



**3.3 Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike vendore.**

**Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes.** Bashkia Berat planifikon per vitin 2018 shumen prej 249 113 0000 leke shpenzime operative dhe te mirembajtjes , kundrejt 222 473 000 leke pritshmeria e realizimit te ketij zeri 2017, (pa perfshire Shumen 36 262 000 leke e trasheguar nga viti 2016, per transferten specifike), ne % rritja eshte 11.9 ose ne vlere absolute 26 640 000 leke. Efekti financiar I shteses se te ardhures se trasheguar nga Transferta specifike prej 36 000 000 leke ul me 3.6% parashikimin e shpenzimeve operative per vitin 2018.

Ne vitin 2016 fakti I realizimit te ketij grup shpenzimi ishte ne Shumen 186 578 000 leke. Ky grup shpenzimi ka trend rritesh me synimin e permiresimit te cilesise se sherbimeve publike vendore , administrimit dhe mirembajtjes me te mire te ambjenteve mesimore , infrastruktures rrugore, mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta, permiresisit te ndicimit public etj.

Parashikohet te zene rreth 25% te totalit te shpenzimeve vjetore, duke ruajtur trendin rrites nga njeri vit ne tjetrin.

**SHPENZIMET OPERATIVE, TË MIRËMBAJTJES DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE NE DINAMIKE.**

000/leke				
Fakt 2016	I pritshmi 2017	Parashikimi 2018	parashikimi 2019	parashikimi 2020
183 625	222 473	249 113	297 706	299 345

Ne kapitujt pauses jepen argumeta te plote ne llogaritjen dhe planifikimin e artikujve dhe nenartikujve te shpenzimeve operative, sipas programeve dhe njesive shpenzuese.

**Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja.**

**Projekti: “Ndërtimin e Banesave me Qëllim Social”,** shuma e disburësuar e kredise eshte 587,707 Euro.

Në bazë të marrëveshjes të nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Berat , me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.12 datë 18.03.2011 “Mbi miratimin e mases se qerases se banesave me qellim social si dhe hapjen e nje llogarie te vecante ne nje banke te nivelit te dyte”, mbeshtetur ne VKM nr. 260 date 24.02.2010 “Per metodiken e llogaritjes se mases se qerases , kur banesat sociale financohen nga buxheti I shtetit, ose i bashkive apo nga kombinimi i te dyjave” pika 11.

Ne kete marreveshje jane percaktuar kesetet e shlyerjes se principalit sipas viteve. Bashkia Berat i ka respektur me korrektesi afatet dhe shumat perkatese.





## BASHKIA BERAT

- Gjendja e llogarisë së banesave sociale ne nje banke te nivelit te dyte ,më 31.12.2016 është 15,770,082 lekë , Te ardhurat totale te realizuara nga vjelja e qirave e banesave sociale gjate vitit 2017, jane 4,003,317 leke.
- Shlyerja e kredise ka filluar më date 19.12.2014 në vlerën 18,700 €
- Në vitin 2015 në vlerën 45,700 € nga të cilat 27,000 € nga fondi i bashkisë dhe 18,700 € nga fondi i banesave sociale.
- Ne vitin 2016 kësti i shlyer ka qënë në vlerën 56,170.7 € i shlyer përkatësish nga fondi i bashkisë dhe 29,170.7 € nga fondi i banesave sociale 27,000 €
- Ne vitin 2017 kësti i shlyer është në vlerën 58,770.7 € i shlyer nga fondi i bashkisë dhe 31,770.7 € nga fondi i banesave sociale 27,000 € .

Ne total duke filluar që nga viti 2014 është paguar shuma prej 179,341.4 € nga të cilat 106,641€ e shlyer nga fondet e bashkise dhe 72,700 € e shlyer nga fondet e banesave sociale mbetet për tu shlyer shuma prej 408,365.6 €.

- Shlyerja e kështit te kredise për vitet 2018 , do te jete në vlerën 58,770 € nga të cilat 31,770 € do të shlyhet nga fondet e bashkisë dhe 27,000 € do të shlyhen nga fondi i banesave sociale.

#### .4 Shpenzimet për subvencione.

000/lek

Emertimi	F.2016	P.2017	P.2018	P.2019	P.2020
Futbolli	30,000	33,000	27,000	27,000	27,000
Bonus Strehimi	1,130	1,200	1,200	1,250	1,300

#### .5 Transferta tek organizatat dhe individë.

Ne transfertat qe bashkia Berat, do te kryej per vitin 2018 dhe dy vitet pasues, mbeshtetur ne pervojen e viteve te meparshme do te jene:

1. Transferte Keshillit te Qarkut (Kuote) sipas ligjit 68/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, neni 38 pika 3.
2. Detyrim kontraktual Ndermarrjes Ujesjelles-kanalizime ne rolin e agjentit tatimor, per sherbimin qe kryen per mbedhjen e tarifave vendore te pastrimit, gjelberimit dhe ndicimit nepermjet fatures mujore te ujit.
3. Transferimi i tarifave vendore qe paguan biznesi i zones BID (Pedonalja)
4. Transferte Drejtorise Rajonale te Tatime per tatimin e thjeshtur (1 % mbi shumen e arketuar , percaktuar me ligj.)

Transfertat	2016	2017	2018	2019	2020
Keshilli I Qarku	1,000,000	3,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Detyrim kontraktual UKBK	659,100	403,125	1,000,000	1,000,000	1,000,000





BASHKIA BERAT

Partneritet Shoqata BID	772,400	1,276,134	1340,000	1 340,000	1 340,000
Transferte per DRI	75,000	36,000	500,000	500,000	500,000

6. **Fondi rezerve, Fondi i kontigjences, fondi i emergjencave civile.**

➤ Ba  
zuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 te ligjit nr. 9936, date 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisve të qeverisjes vendore, krijohet **Fondi Rezervë**.

➤ Per  
të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet **Fondi i Kontigjences**. Te dy këto fonde miratohen në masën deri ne **3 (tre) %** të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

➤ **Fondet e Emergjences** planifikohen per te përballuar situata emergjente. Ne zbatim te nenit 16 te ligjit nr. 8756 date 26.03.2001 “Per Emergjencat Civile ” te ndryshuar, te nenit 29 te ligjit nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, te pikes III/3 te VKM nr.329,date 16.05.2012, “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore”

➤ Parashikimi i fondeve te emergjencave civile dhe fondit rezerve eshte mbeshtetur ne pervojen e viteve te meparshme, ndersa fondi I kontigjence parashikohet per here te pare ne vitin 2017 dhe u perdor ne zbatim te VKB nr. 18 date 28.02.2017.

Emertimi	2016	2017	2018	2019	2020
Fondi Rezerve	1,470	1,671	2,500	2,500	2,500
Fondi i Emergjences	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500
Fondi i Kontigjences	0	4,000	6,000	9,000	9,000
<b>Totali</b>	<b>3,970</b>	<b>8,171</b>	<b>11,000</b>	<b>14,000</b>	<b>14,000</b>

7. **Fondi I investimeve:**

**Planifikimi për investime (230, 231) nga fondet e bashkise.**

Investimet ne total per njesite e qeverisjes vendore përballohen nga të ardhurat e veta të njësisve të qeverisjes vendore, transferta e pakushtëzuar, nga buxheti i shtetit, nepermjet Fondit te Zhvillimit te Rajoneve si dhe donator dhe partner.

Ne terma real fondi I investimeve nga te ardhurat e bashkise ka trend rrites nga njeri vit ne tjetrin.





## BASHKIA BERAT


- i. Ne vitin 2014 (para reformes ) u planifikua 78.2 milion lek investime ose 17 % e buxhetit.
- ii. Ne vitin 2015 u planifikua 74.4 milion lek investime ose 17 % e buxhetit ,dhe u realizuan 63.7 milion leke.
- iii. Ne vitin 2016 u planifikua 173.2 milion lek investime ose 15 % e buxhetit, dhe u realizuan 131.2 milion leke.
- iv. Ne vitin 2017 u planifikua 235.4 milion lek investime ose 23 % e total buxhetit ose 32.2 % e buxhetit te vet bashkise (Grand + te ardhura).
- v. Ne vitin 2018 kemi planifikuar 237.4 milion lek investime ose 24 % e totalit te buxhetit ose 31.2% e buxhetit te vete bashkise,(Grand + te ardhura).

Ne terma real rritja eshte **159.2** milion leke, krahasuar me vitin 2014(Vitit para reformes).

Bashkia Berat planifikon per vitin 2018, 237 420 000 leke me te cilat do te perballohen:

- Investimet ne proces nga viti 2017 dhe qe kane kontrate shtrirje ne dy-tre vite.
- Investime te reja te programuara ne periudhen afatmesme 2018-2020. Hollesisht per cdo objekt dhe program kemi pasqyren ne fund te materialit.

*Paraqitja grafike e dinamikës së fondeve të investimeve nga të ardhurat e bashkise.*



#### 4. PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE TE ZHVILLIMIT TE QYTETIT

##### 4.1 Programi i administrimit të përgjithshëm të bashkise (planifikim, menaxhim, administrim) Aparati I bashkise

Planifikojme per kete program 183 556 000 leke, nga te cilat shpenzime korrente 170 556 000





\*

\*



BASHKIA BERAT

Nr.	Emertimi	Fakt 2016	I prit. 2017	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020
1	Paga dhe sigurime	104 248	115 157	131 600	133 318	137 318
3	Shpenzime operative	12 708	15 570	15 436	17 125	17 639
4	K bashkiak +k.Fshatrave	7 203	7 260	8 020	8 261	8 508
5	Shpenzime gjyqesore	1 771	10 250	15 500	15 965	16 444
6	Investime	48 570	55855	13 000	28 658	2 500
Totali		174 936	204 333	183 556	203 326	182 408

Pasqyra analitike e shpenzimeve per vitet 2016, 2017, 2018 per Aparatin e Bashkise

000/lek

Llog.	Pershkrimi	Fakti 2016	I pritshmi 2017	Plan 2018	Ndryshim % 2018/2017
<b>600+601</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>104,248</b>	<b>115,157</b>	<b>131,600</b>	<b>14</b>
600	Paga	89,596	98,493	113,541	15
601	Sigurime	14,652	16,664	18,059	8
<b>602</b>	<b>Shpenzime operative</b>	<b>21,682</b>	<b>33 080</b>	<b>38 956</b>	<b>17.7</b>
<b>6020</b>	<b>Materiale zyre dhe te pergj</b>	<b>2,119</b>	<b>2,920</b>	<b>2811</b>	<b>-3.7</b>
6020100	Kancelari	603	950	800	-15.7
6020200	Mat.pastr.ngro.etj	203	170	250	47
6020300	Sherbim Printimi	580	700	800	14
6020500	Blerje dokumentacioni	666	400	420	5
602099	Furn. me mat te tjera zyre te ndr	67	700	541	-23
<b>6021</b>	<b>Materiale dhe sherb speciale</b>	<b>323</b>	<b>180</b>	<b>270</b>	<b>50</b>
6021010	Uniforma dhe veshje spec	323	180	270	50
6021099	Te tjera mat dhe sherbime spec	-	-	-	-
<b>6022</b>	<b>Sherbime nga te tretet</b>	<b>4,567</b>	<b>5,600</b>	<b>5,215</b>	<b>-6.9</b>
602201	Energji elektrike	1,852	2,350	2,250	- 4
602202	uji	793	900	865	- 4
602203	telefon	468	350	100	-71
602204	Sherbime postare	512	1,050	1,050	-
602299	Sherbime te tjera(tarife rregj. prona etj.)	942	950	950	-
<b>6023</b>	<b>Shpenzime transporti</b>	<b>2,137</b>	<b>2,700</b>	<b>2,930</b>	<b>9</b>





## BASHKIA BERAT

6023100	karburant	1,621	1,900	2,100	11
6023200	Pjese kebimi, goma, bateri etj	336	600	680	13
6023300	Siguracion mjetesh	97	100	75	(25)
6023900	Te tjera	83	100	75	(25)
<b>6024</b>	<b>Shpenzime udhetimi</b>	<b>990</b>	<b>1,200</b>	<b>1,250</b>	<b>4</b>
<b>6025</b>	<b>Shpenz te tjera per mirembajtje &amp; mirmb. Sistemit TAIS etj.</b>	<b>456</b>	<b>500</b>	<b>800</b>	<b>60</b>
<b>6026</b>	<b>Shpenzime per qeramarrje</b>	<b>296</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>6029</b>	<b>Shpenzime te tjera operative</b>	<b>10,794</b>	<b>19,980</b>	<b>25,680</b>	<b>28.5</b>
6029001	Pritje percjellje	226	600	600	-
6029002	Aktivite+ Konferenca	85	870	810	-2
6029003	Shpenzime gjyqesore	1,771	10,250	15,500	51.2
6029004	Sigurimi i ndertesave	-	200	0	-
6029005	KPP, KA	268	300	300	-
6029006	Keshilli Bashkiak + Kr. Fshatrash	7,203	7,260	8,020	10
6029099	Te tjera Operative	1,241	500	450	-10
<b>606</b>	<b>Perdorimi i fondit te vecante</b>	<b>436</b>	<b>241</b>		<b>-</b>
<b>230-231</b>	<b>Investime</b>	<b>48,570</b>	<b>55,855</b>	<b>13,000</b>	<b>(77)</b>
2312101	Rikonstruksion ndertesa e Bashkise	43,285	49,914		-
2315120	Automjet	4,668	-	-	-
2317800	Pajisje	617	5,941	5,000	(16)
2314170	Sistemi i kondicionimit godina e Bashkise			8,000	-
<b>Total Buxheti</b>		<b>174,936</b>	<b>204,333</b>	<b>183,556</b>	<b>(10)</b>

Sic shihet nga te dhenat analitike te pasqyres se mesiperme ne total shpenzimet operative (602) jane planifikuar me trend rrites, 17.7 % , ndersa shpenzimet e investimeve me ulje pasi ne vitin 2017 kemi planifikuar shlyerjen e kontrates se rikonstruksionit te Bashkise, investim I shtrise ne dy vite buxhetore.

Persa i perket shpenzimeve operative ato jane parashikuar mbeshtetur ne pervojen e vitit te meparshem si dhe ne analizen ze per ze te shpenzimeve.

Shpenzimet e transportit për administratën (Aparati) i Bashkisë eshte mbeshtetur ne :

Numri i mjeteve në punë 4 (katër ) dhe klasifikimi i tyre sipas tipeve dhe targave :

- 1- M.Benz me targë AA 001MI , normativa e harxhimit te karburantit diezel 11litra/100 km.
- 2- M.Benz me targë AA 341 AN me norme konsumi 10 litra /100 km.
- 3- Opel VIVARO me targë AA 812 IZ , me norme 8.8 litra/100km
- 4- Mitsubish me targë AA 037 NK me norem konsumi mesatare 7.8 litra /100lm.

#### 4.2 Programi i Zhvillimit Ekonomik





## BASHKIA BERAT

**Pershkrimi i Programit.** Programi i zhvillimit ekonomik përpiqet të bëjë bashkërendimin e planeve dhe politikave buxhetore me nevojat ekonomike të Bashkise Berat.

Ne themel të Programit qendron angazhimi maksimal për sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme për funksionimin normal të Njesise së Qeverisjes Vendore.

**Politika e Programit.** Krijimi dhe zhvillimi i një mjedisi ekonomik në mënyrë të tillë që të jetë sa më atraktiv dhe konkurrues, i cili do të konsolidojë dhe garantojë qëndrueshmërinë ekonomike gjatë një periudhe afatmesme.

**Njësitë shpenzuese:** Bashkia Berat

**Objektivat e politikës së programit.**

- Gjetja e menyrave më efikase për zgjerimin e bazës së taksueshme të bizneseve dhe të familjeve.
- Vlerësim sa më real i detyrimeve të taksapaguesve nga ana e administratës tatimore vendore.
- Ofrimi i një shërbimi me cilësi dhe brenda një kohe sa më të shkurtër, në sajë edhe të informatizimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore.
- Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukurës së nevojshme për rritjen e biznesit.
- Asistencë dhe këshillim nga administrata tatimore vendore për çdo biznes që kryen aktivitet tregtar si dhe për çdo individ i cili dëshiron të çelë aktivitet të ri tregtar.
- Përmirësimi i administrimit të të ardhurave vendore.
- Mbeshtetje, marketing, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.
- Mbeshtetje e biznesit për të diversifikuar aktivitetin e tij dhe **nxitja e sipërmarrësve të rinj** me synim krijimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme dhe konkurruese në rajon.
- Promovimi dhe mbështetja e biznesit, hartimi i politikave për thithjen e biznesit të ri inovativ në bashkinë e Beratit me anë të lehtësimit të taksave dhe subvencioneve.

**Projektet:**

- Organizimi i Panairëve vjetorë të produkteve vendase në Bashkinë Berat.
- Funkcioni i tregut të shumicës në shërbim të Bashkisë Berat dhe Tregu I Frutave perimeve Morave.
- Hartimi i Strategjisë së Marketimit të Produkteve vendase.

1	Programi	Nxitja e Bizneseve Turistike në Qytetin e Beratit
---	----------	---





## BASHKIA BERAT

2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Grante Zhvillimore për Bizneset Turistike në Qytet</b>
3	<b>Kohëzgjatje</b>	2 Vjet
4	<b>Data e fillimit</b>	Shkurt 2018
5	<b>Donator potencial</b>	CESVI
6	<b>Kostoja totale</b>	2.000.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	890 + Burime Njerëzore dhe Infrastrukturore
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Rritja e kapaciteteve teknike dhe prodhuese e bizneseve turistike</li><li>- Rritja e numrit të produkteve turistike</li><li>- Rritja e numrit të tatimpaguesve në Bashkinë Berat</li><li>- Rritja e numrit të të punësuarve në sektorin e turizmit</li></ul>
10	<b>Objektivat</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Zhvillimi i bizneseve turistike në qytetin e Beratit</li><li>- Rritja e numrit të produkteve turistike në qytetin e Beratit</li><li>- Rritja e ofertës turistike në Berat</li></ul>
11	<b>Indikatorët</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Numri i bizneseve i pajisur me asistencë financiare</li><li>- Numri i produkteve turistike të krijuara</li><li>- Numri i personave të punësuar rishtas</li><li>- Rritja e sasisë së shpenzimeve në sektorin e turizmit</li></ul>
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Hapja e konkursit për mbështetjen e bizneseve të reja</li><li>- Përcaktimi i fituesve</li><li>- Financimi me anë të Organizatës CESVI</li></ul>
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	CESVI; Bashkia Berat
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve
15	<b>Shënime</b>	

### 4.3 PROGRAMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE VENDORE.

#### 4.3.1 GJELBERIMI :

**Politika e Programit.**Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve mjedisore sa me te kendshem dhe funksionale, brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti shlodhes dhe qetesie ku qytetarët te kalojnë një pjesë të kohës së tyre, duke nderhyre edhe në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti.

**Njësia Shpenzuese:** Bashkia Berat, Ndermarja e Gjelberimit

#### Objektivat e Programit





- Mirembajtjen e struktureve se siperfaqeve te gjelberta duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure te gjelber.
- Shtimi i siperfaqeve te gjelberta duke shtuar mbjelljet me lule sezonale, siperfaqe me bar, mbjellja e pemeve dekorative etj.
- Mirembajtja e tendave dhe e pjergullave.
- Mirembajtja e qoshkave dekorative, tavolinave dhe stolave ne te gjitha siperfaqet e gjelberta.
- Krijimin e nje lulishteje te re ne Lagjen "30 -vjetori".
- Rehabilitimi i lulishtes perballë shkolles "Zihni Toska" sapo te zgjidhet problemi per statusin juridik te pronesise.

#### **Produktet që synohen të ofrohen**

- Kryerjen e të gjitha proceseve teknologjike të punës si punim toke, vaditje, prashitje, krahsitje, plehrim, pastrim, grumbullim mbeturinash etj. në një sipërfaqe të gjelber prej **93.203 m<sup>2</sup>** ku nga kjo 16.804 m<sup>2</sup> është siperfaqe rruge e sheshe, 70.336 m<sup>2</sup> është siperfaqe bar (tapete), 4.821 m<sup>2</sup> siperfaqe lule.
- Mirembajtja e **467 stolave** per te ofruar gjithmone vende shplodhjeje per qytetaret.
- Mirëmbajtje e gjithë inventarit të perfshire ne siperfaqet e gjelberta si, pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndicuesa, cezma zbukuruese, kende lojrash per femije, e kende argetuese per moshat e treta, lapidar, buste, skulptura.
- Mbjellja e **320 rrenje druresh te rinj, 600 shkurreve** në rrugë e lulishte dhe mjellja e me shume se **200 rrenje trendafila** ne lulishtet e qytetit, duke synuar te rikthejme traditen.
- Mjellja me lule sipas sezoneve e **4821 m<sup>2</sup> siperfaqe lulesh.**

#### **Aktivitetet që synohen të realizohen**

- Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per nenpunesit dhe punonjesit e Ndermarrjes se Gjelberimit.
- Plotesimi i kerkesave per kushte normale te punes ne administrate.
- Sigurimi i materialeve baze dhe sherbimeve speciale.
- Realizimi i sherbimeve ndaj te treteve. Realizimi i shpenzimeve te transportit.
- Mirembajtja e mjeteve te transportit, pajisjeve te zyrave dhe vet ambienteve te zyrave nepermjet realizimit te shpenzimeve te mirembajtjes se zakonshme.
- Realizimi i shpenzimeve te tjera operative.

#### **4.3.2. PASTRIMI.**

**Përshkrimi i Programit.** Programi i shërbimit të Pastrimit parashikon pastrimin, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane dhe inerte të qytetit nga vendgrumbullimet deri në pikën e vend





## BASHKIA BERAT

---

depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit tonë me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes së tij në qytet. Ky shërbim është shtrire edhe në njesite administrative të bashkisë.

**Politika e Programit.** Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve higjieno - sanitare dhe mjedisore brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti sa më të pastër në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti, si dhe në ambientet ku qytetarët të shlodhen, apo kalojnë një pjesë të kohës së tyre (në institucione publike si kopshte, shkolla etj.)

**Njësia Shpenzuese :** Sipërmarja e shërbimit të pastrimit të qytetit me vlerë vjetore të kontraktuar në shumën 54 496 699 leke.

Sipërmarja e shërbimit të pastrimit të Njesive Administrative me kontrate vjetore në shumën 7 122 406 leke. (blerja e kazaneve është parashikuar në vitin e parë të sipërmarrjes).

### **Objektivat e Programit**

- Pastrimin e Rrugëve dhe Shesheve kryesore të qytetit për të krijuar qytetarëve një ambient të pastër.
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në pikat e vend-qëndrimeve të kontejnerëve dhe pikave statike çdo ditë për të krijuar ambiente sa më të pastra dhe uljen e ndotjes në maksimum në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike).
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve inerte në pikat e vendgrumbullimeve dhe pikave statike çdo ditë për të eliminuar ndotjet në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike) si dhe në ruajtjen e infrastrukturës mjedisore në standarde që kërkon koha.
- Larja dhe lagia e rrugëve, në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit për uljen e ndotjes mjedisore nga qarkullimi i makinave dhe punimet ndërtimore.
- Përmirësimi i kushteve teknike në vend depozitimit të mbetjeve urbane për uljen e ndotjes së ambientit të qytetit.
- Përmirësimi i kushteve teknike në dezinfektimin e pikave nevalgjike në qytet që shkaktojnë ndotje të ambientit dhe në institucionet publike (në vendstrehimet, kopshtet, shkollat, spitalet etj.)

### **Produktet që synohen të ofrohen**

1. **Pastrimi i Rrugëve.** Pastrimi i rrugëve sipas skemës dhe zgjerimi i kësaj skeme në vitet në vazhdim sipas standardeve bashkëkohore duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit si dhe uljen e ndotjes në mjedisin rrethues.
2. **Mirëmbajtja e Ambienteve Publike.** Uljen e ndotjes në mjediset publike ku përfshihen blloqet e pallateve dhe lagjeve të qytetit të cilat nuk janë të planifikuara në skemën e shërbimit ditor.





**3. Grumbullim – transportim i mbetjeve urbane.** Largimi çdo ditë sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve urbane nga vendgrumbullimi i kontejnerëve dhe pikave statike.

**4. Grumbullim – transportim i mbetjeve inerte (ndërtimore).** Largimi sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve inerte nga vendgrumbullimi i mbetjeve urbane dhe ambientet publike.

**5. Larje dhe lagie e rrugëve.** Larjen e rrugëve për uljen e ndotjes dhe lagie të rrugëve kryesore gjatë sezonit Prill-Tetor sipas një grafiku të miratuar.

**6. Dizinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektimi.** Dizinfektimin, deratizimin, dizinsektimin e ambienteve publike për të pasur nja ambient sa më të shëndetshëm për komunitetin.

**7. Mirëmbajtja e Vend-Depozitimit të mbetjeve urbane.** Kavaletimi i mbetjeve urbane në vend depozitime për krijimin e kushteve sa më të mira ambientale për mbrojtjen nga vetëdëzja dhe zjarret e mundshme.

**8. Mirëmbajtje e mjeteve që kryejnë pastrimin e qytetit.** Për një shërbim çdo ditë të ambienteve ku komuniteti ka në përdorim duhet dhe një gatishmëri sa më efektive e mjeteve që përdoren për largimin e tonelatave mbetje urbane dhe inerteve.

**Paqsyra e dinamikës së shërbimeve publike vendore për periudhën 2016-2020.**

000 /lek

Pershkrimi	Fakti 2016	I Pritshmi 2017	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
Pastrimi Qytet	53,103,	52,516,	54,496,	54,496,	54,496,
Pastrimi Fshat	9,304,	7,122,	7,122,	7,122,	7,122,
Mirembajtje e Varrezave	129,	3,258,	3,258,	3,258,	3,258,
Dekori	0	0	720	720	720
Mirembajtje e Lapidareve	0	0	28	28	28
<b>Totali Shërbime Publike</b>	<b>62,537,</b>	<b>62,896,</b>	<b>65 625.</b>	<b>65 625.</b>	<b>65 625.</b>

### **1 Mirembajtja e varrezave publike, varrezave të deshmorëve.**

**Njësia Shpenzuese;** Bashkia Berat, Sipermarja e shërbimit

Mirëmbajtje e parcelave në varrezat publike dhe të dëshmorëve sipas preventivit perkates të sipemarrjes së këtij shërbimi.

Nevoja për zgjerim dhe investim në varrezat publike në vitet 2018-2019.

Siperfaqet e varrezave të Bashkisë Berat janë si më poshtë:







## BASHKIA BERAT

---

1. Varezat Publike te qytetit Berat 150.000 m<sup>2</sup>
2. Varezat Publike Velavisht 141.820 m<sup>2</sup>
3. Varezat Publike Otlak 195.118 m<sup>2</sup>
4. Varezat Publike Rroshnik 29.145 m<sup>2</sup>
5. Varezat Publike Sinje 138.950 m<sup>2</sup>
6. Varrezat deshmoret e Kombit 6.000m<sup>2</sup>

Duhet te behet sistemimi i siperfaqes se re ne Suelas, ku me sistemimin kemi parasysh rethimin me mu rte tyre, ndertimi i objekteve sipas rregullores se sherbimeve te varrimit. Ndertimi i rrugeve kaluese brenda siperfaqes se varrezave etj.Siperfaqja e re qe u shtua ne varrezat e Suelasit eshte 37.580 m<sup>2</sup>.3

### **4.3 MENAXHIM RRUGOR & NDCIM PUBLIK.**

**Pershkrimi i Programit.** Programi i Mirëmbajtjes së rruge trotuareve dhe ndicimit publik ne Njesite Administrative nr. 1, nr. 2 , nr. 3 , Roshnik , Otlak , Velabisht , Sinje parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldreve , mirembajtjen e sistemit te ndicimit të qytetit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.

**Politika e Programit.** Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukture dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te ndicimit publik.

**Njësitë Shpenzuese :** Bashkia Berat, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike

### **Objektivat e Programit**

- Përmirësimin e rrjetit ekzistues te rrugeve te asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve.
- Rritja e siperfaqeve te shtruara me kalldrem ne masen 4.3 %, per periudhen 2017.
- Te mirëmbahen trotuaret , kalldremet ekzistuese dhe te shtohen siperfaqet e reja te tyre.
- Te mirembahet rrjeti ekzistues i ndicimit publik dhe te mundesohet mbulimi i zonave te reja me ndicim.

### **Produktet qe synohen te ofrohen**

#### **1.Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve.**





Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara, duke vendosur puseta. Këtu do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojës. Siperfaqja totale e rrugëve është 857 323 m<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë nga të cilat 239 231 m<sup>2</sup> janë të trajtuara me asfalt dhe 618 092 m<sup>2</sup> me stabilizant.

Njesia	Stabilizant m <sup>2</sup>	Tombino
Velabisht	125000	24
Otlak	167100	24
Roshnik	57000	36
Berat	129692	12
Sinje	139300	24
<b>Totali</b>	<b>618 092</b>	<b>120</b>

• **Mirëmbajtje e urave 13 cope**

- 1- Ura e Gorices me gure
- 2- Ura e Varur (konstrukcion me kavo celiku)
- 3- Ura e Re (konstrukcion beton arme me parmak druri)
- 4- Ura e Varur e Gjorovenit me derrasa
- 5- Ura e Varur e Lapardhase me derrasa

**2. Mirëmbajtja e Rrugëve me kalldrem dhe trotuareve.**

Mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me kalldrem dhe shtimi i sipërfaqeve të reja. Gjithsej kemi 80 942 m<sup>2</sup> që do të mirëmbahen.

Per vitin 2018 do të shtohen 3500 m<sup>2</sup> të reja në këto segmente rrugore :

- Rruga Kostandin Kristoforidhi 1200 m<sup>2</sup>, Rruga Lisi i Becit 620 m<sup>2</sup>, Rruga Vangjel Zoto 1680 m<sup>2</sup>.

**3. Mirëmbajtja e shesheve;** Sheshi 'Xhimitiku' 85 m<sup>2</sup> me asfalt, Sheshi 'Kumsalla' 80 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Sallabanda' 900 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Tabia' 800 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Shen Gjergji' 1000 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Akropoli' 6500 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Kostandin i Madh' 800 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Onufri' 60 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Fusha e Madhe' 2300 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Porta e Madhe' 900 m<sup>2</sup> me kalldrem, Sheshi 'Akhensia' 3700 m<sup>2</sup> me asfalt, Sheshi 'Demokracia' me asfalt, Sheshi 'Jani Vruho' 900 m<sup>2</sup> me asfalt

**4. Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të larta dhe të pusëtave në Njësine Administrative nr. 1, nr. 2, nr. 3, Velabisht, Sinje, Otlak, Roshnik.**

- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujërave të bardha në 830 zgara të vogla ekzistuese në Njësiet Admin. Nr. 1, nr. 2, nr. 3.





## BASHKIA BERAT

- Mirëmbajtja dhe pastrimi kanalizimeve te ujrave te larta ne 30 zgara pritesa te medha ne te gjitha territorin e bashkise
- Parashikohet te vendosen zgara pritesa per ujrat e larta 50 cope ne te gjitha territorin e Bashkise.
- Pastrimi i perrenjve te meposhtem :  
Perroi i Kananit, Perroi i Lisit i Te Becit, Perroi i Suelasit , Perroi Pusi me Cati , Perroi i MCR,Perroi ne lagjen “ 1 Maji’ .Sistemimi i perroit te Avramit ne lagjen 13 Shtatori
- Sistemimi i ujrave te bardha ne lagjen Kala

### 5. Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore

- Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave , duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarrës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.
- Vijeziimi i vijave te bardha te kembesoreve me permasa 3 x 0.5 m , ne total 1398 m<sup>2</sup> ne rruget :
  - Rruga Antipatrea ( Ura e Anit – Uznove e Madhe ),Rruga Ura e Re,Shtetore Osumi ,Rr. Santa Lucia.
- Vijeziimi i vijave gjatesore trafik ndarese me gjeresi 12 cm , ne total 23400 ml ne rruget :
  - Rruga Antipatrea ( Ura e Anit – Uznove e Madhe ) ,Rruga Ura e Re,Shtetore Osumi,Rr. Santa Lucia

### 6. Mirëmbajtje Ndrëçimi Rrugor. Përfshihet mirëmbajtja e rrjetit të ndrëçimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndrëçimit rrugor në rrugët e qytetit dhe fshatrat , riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, qe kap nje gjatesi te ndicuar prej 37.89 km .

- Shtim i gjatesive te ndicuara ne masen 3 km ( nga keto 2 km do plotesohen me blerjen e ndrëçuesve te rinje dhe 1 km nga heqja e ndrëçuesve te vjeter ).
- Rikonstruksioni i rrjetit të ndrëçimit rrugor në rrugët të cilat kanë pasur ndrëçim rrugor, por sot nuk funksionon për shkak të dëmtimit të rrjetit, ku parashikohen punimet për vendosjen e koka ndrëçuesi ose llamba, rrjeti kabllor i nevojshëm, etj.
- Programe manaxhimi dhe ekonomizimi te energjise elektrike nepermjet zevendesimit te llampave ekzistuese me llampa ekonomike led.

Fshati	Gjatesia ne ml e rrugëve te ndrëçuara	Nr. Ndrëçueve
Otlak	750	18 ndrëçues
Lapardha	80	9 ndrëçues
Orizaj	1000	14 ndrëçues
Roshnik	1700	24 koka
Vojnik	700	8 ndrëçues
Sinje	150	5 ndrëçues
Galine	400	9 ndrëçues



**5. Mirmbajtja e rrugëve rurale të asfaltuara (Inventari i rrugëve sipas VKM nr 915 dt 11.11.2015 )**

Rruga Sinje – Velçan 8 km, Rruga K/ Dyshniku – Roshnik 1.1 km, Rruga Duhanas – Roshnik 8 km, Rruga K/Velabishtit – Starove 1.5 km, Rruga K/ Gjerovenit – Gjeroven 4 km, Rruga K/ Duhanasit – Duhanas 4 km, Rruga K/ Bilç – Malinat 18 km, Rruga Ure Vajgurore – Veterik 3 km, Rruga K/ Lapardhase – Lumas 12 km, Rruga Berat – Sinje 22 km.

**PROGRAMI I ARSIMIT DHE EDUKIMIT.**

**Pershkrimi i Programit.** Programi i arsimit parauniversitar dhe edukimit parashikon veprimtarine ekonomike, financiare dhe ate te sherbimit ne mirembajtjen e kopshteve, cerdheve dheshkollave 9-te vjecare, te mesme te pergjithshme dhe profesionale qe jane brenda territorrit dhe juridiksionit te Bashkise Berat.

**Politika e Programit.** Politika e ketij programi konsiston ne ofrimin e kushteve optimale per mirerritjen e femijeve te moshes(0-3 vjec) per cerdhet dhe (3-6 vjec) per kopshtet si dhe sigurimin e nje infrastrukture arsimore bashkekohore per nxenesit.

**Njësia Shpenzuese:** Bashkia Berat, Drejtoria e Arsimit, Buxheti i shtetit

**Pozicioni gjeografik dhe numri i institucioneve (qytet+fshat)**

**Arsimi parashkollor**

Në të gjithë territorin e Bashkisë Berat ndodhen **46 kopshte**, nga të cilat 29 janë ndërtesa të reja dhe 17 kërkojnë riparime.

**Në qytetin e Beratit** shërbejnë **14 kopshte**, janë të vendosura në pjesën jug- perëndimore të qytetit. Në pjesën tjetër të qytetit, mungon ky shërbim.

Sinja përbëhet nga 14 fshatra, nga të cilat vetëm 7 ofrojnë shërbimin e kopshteve. Velabisht përbëhet nga 13 fshatra, 11 prej tyre kanë një kopësht.

Njësia Otlak e siguron këtë shërbim në 8 fshatra nga 11.

Njësia Roshnik është njësia e cila ka numrin më të vogël të kopshteve që shërbejnë, 3 dhe numrin më të madh të fshatrave që nuk e sigurojnë këtë shërbim.

Nga 46 kopshte vetëm 9 plotësojnë standartet e projektimit 18m<sup>2</sup>-25m<sup>2</sup>/fëmijë. Nga të cilat 3 ndodhen në Berat, 1 në Sinjë, 2 në Roshnik dhe 3 në Velabisht. Njësia Otlak nuk ka asnjë kopësht që plotëson standartet e projektimit.





## BASHKIA BERAT

### Arsim 9 vjeçar

Në Bashkinë Berat shërbejnë 43 shkolla 9 vjeçare, 27 prej tyre janë ndërtesa të reja dhe 16 kërkojnë riparime. Njësia Otlak dhe Velabisht sigurojnë mbulimin e 80 % të territorit me këtë shërbim. Njësia Sinjë lë jashtë rrezes së mbulimit 6 fshatra. Në Roshnik, 4 fshatra nuk sigurojnë shërbimin me shkolla 9 vjeçare.

Nga 43 shkolla që shërbejnë në Bashkinë Berat, vetem 1 plotëson standartet e projektimit 20m<sup>2</sup>-25m<sup>2</sup>. Kjo shkollë ndodhet në njësinë Velabisht ( 20.9m<sup>2</sup>/fëmijë).

### Arsim i mesëm

Në Bashkinë e Beratit shërbejnë 11 shkolla të mesme, 7 ndodhen në qytetin e Beratit prej të cilave 3 janë shkolla të mesme profesionale. Njësitë e tjera kanë nga një shkollë të mesme. 9 prej ndërtesave janë të reja dhe 2 janë të amortizuara.

Berati mbulon me këtë shërbim rreth 80% të territorit. Njësia Velabisht dhe Sinjë mbulojnë vetëm 40 % të territorit. Otlaku dhe Roshniku mbulojnë me këtë shërbim 50% të territorit.

Tabela 1 . Hapësirat arsimore të njësive dhe standartet e projektimit

Niveli i arsimit	Standartet e projektimit	Berat	Velabisht	Otlak	Sinjë	Roshnik
Kopësht	18m <sup>2</sup> / fëmijë	7.3m <sup>2</sup> / fëmijë	12.34m <sup>2</sup> / fëmijë	3.8m <sup>2</sup> / fëmijë	12.3m <sup>2</sup> / fëmijë	13.1m <sup>2</sup> / fëmijë
9 vjeçar	20m <sup>2</sup> -25m <sup>2</sup> / fëmijë	1.5m <sup>2</sup> / fëmijë	4.30m <sup>2</sup> / fëmijë	2.24m <sup>2</sup> / fëmijë	4.36m <sup>2</sup> / fëmijë	3.9m <sup>2</sup> / fëmijë
I mesëm	20m <sup>2</sup> -23m <sup>2</sup> / fëmijë	3.05m <sup>2</sup> / fëmijë	4.32m <sup>2</sup> / fëmijë	3.50m <sup>2</sup> / fëmijë	4.17m <sup>2</sup> / fëmijë	4.81m <sup>2</sup> / fëmijë

Njësia Shpenzuese: Bashkia Berat, Drejtoria e Arsimit, Buxheti i shtetit

### Objektivat e Programit

- Permbushjen me sukses e te gjitha detyrimeve ligjore ne fushen e arsimit.
- Synimi i permbushjes se standarteve te miratuara nga M.A.SH ne Strategjine e Arsimit,
- Kontrollin e servirjes dhe cilesine e menyse ushqimore per femijet ne kopeshte,cerdhe dhe konvikt
- Krijimin e realizimin e aktiviteteve kulturore per femijet





- *Permiresimin dhe rritjen e efektivitetit ne cilesine e sherbimeve ndaj institucioneve arsimore-si dhe ne forcimin e kontrollit te fondeve te planifikuara ne buxhetin e arsimit.*
- Te realizoje mirembajtjen e kopshteve, cerdheve dhe shkollave te qytetit , duke synuar ne pambushjen e standarteve optimale, duke vleresuar si prioritet rikonstruksionin e plote te shkolles 9-vjecare 1 Maji, Rikonstruksion i plote i shkolles 9 vjecare “Uznove” , Rikonstruksion i plote i cerdhes Uznove” dhe i cerdhes nr.7, Rikonstruksion i plote i shkolles 9 vjecare e te mesme Starove , Rikonstruksion pjesor (Hidrolizim dhe lyerje fasade) i konviktit te shkolles se mesme bujqesore “Kristo Isak” , Rikonstruksion pjesor i shkolles 9-vjecare Veterik, Rikonstruksion i amfiteatrit te shkolles se muzikes Ajete Xhindole, Rikonstruksion i plote i shkolles Dushnik, Rikonstruksion i kopeshtit Donika Kastrioti, sistemimin e ambienteve te jashtme dhe terreneve sportive ne shkollen 9-vjecare Paftal, riparimin e kopeshtit Bilce, rregullimi i fushes sportive ne shkollen 9-vjecare Zihni Toska, riparimin e fushes sportive ne shkollen Mangalem dhe shkollen e mesme Kristaq-Capo, rrethimin e shkolles Roshnik, Bogdan, Karkanjoz, ndertimin e nje kopeshti te ri ne Dushnik dhe fushes sportive ne shkollen Morave, krijimin e nje ambienti per kopesht te ri ne shkollen Drobonik,
- Kompletimin e cerdheve, kopshteve me pajisje te reja, per shkak te amortizimit te pajisjeve ekzistuese.

#### **Materiale dhe sherbimet qe synohen të kryhen**

- **Materiale zyre e te pergjithshme**  
Ketu perfshihen te gjitha materialet per pastrim,disifektim,ngrohje e kopshteve, cerdheve, shkollave, konviktit dhe administrates se qendres ekonomike.
- **Materiale dhe sherbime te tjera special**  
Perfshihen te gjitha ato materiale si: menyja e femijeve me sherbimin e servirjes e gatimit se ushqimit me nenkontaktor te trete, si dhe te tjera materiale dhe sherbime speciale per nevojat e kopshteve,cerdheve,konvikteve dhe shkollave te qytetit.
- **Sherbime nga te trete**  
Perfshihen te gjitha shpenzimet per energjine elektrike,ujin e pijshem dhe telefon per te gjitha institucionet e arsimit parashkollor, 9-te vjecar, te mesem te pergjithshem e profesional si dhe te cerdheve.
- **Shpenzime transporti**  
Perfshihen shpenzimet per transportin per furnizimin me lende drusore te kopshteve,cerdheve,shkollave si dhe transportin per mallrat qe nevojiten per mirembajtjen e godinave,
- **Mirembajtje te zakonshme**  
Perfshihen te gjitha materialet per mirembajtje te ndryshme,riparime e lyerjen e objekteve





arsimore.

Realizimi i shpenzimeve te tjera operative.

## 6. PROGRAMI I KULTURES, ARTEVE, TRASHEGIMISE, TURIZMIT , MARREDHENIET ME JASHTE DHE SPORTEVE.

**N/program Kultura: Pershkrimi** .Programi i Kulturës do te tentoje ti japë një hapësire edhe me te plote jetes artistike dhe kulturore te qytetit jo vetëm duke u mbështetur ne rivitalizmin e metejshem te projekteve ekzistuese, te cilat jane kthyer tashme ne nje tradite per qytetin e Beratit, por edhe duke dhëne hapësira te reja per projekte te tjera inovative te cilat vijne prane Qendres Kulturore e Bashkise Berat nga persona te trete, shoqeria civile apo ente te tjera kombetare e nderkombetare. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të qytetit ç'ka do ta bente jo vetem për qytetarin e Beratit, por edhe turistin dhe vizituesin e tij, me atraktiv.

**Politika e Programit:** Politika e këtj programi synon krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale për qytetin e Beratit duke përfshirë të gjitha grupmoshat dhe nivelet e ndryshme sociale që bashkëjetojnë në Berat dhe promovimin e një qyteti sa më tërheqës dhe konkurues për tregun e biznesit dhe të vizitorëve.

**Njësitë shpenzuese:** Bashkia Berat, Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”, Donatore

### **Objektivat e politikës së programit:**

- 1- Ritja e cilesise se shfaqeve artistike qe jepen nga institucioni. Kjo pike arrihet nepermjet ngritjes se nje komisioni i perbere nga profesionista te fushes artistike dhe kulturore te cilet gjykojne cilesine e projektit artistik
- 2- Ringritja e teatrit ¶Ky objektiv do te realizohet nepermjet implementimit te ideve qe ka regjisorin i cili eshte i specializuar kryesishte ne fushen e teatrit .
- 3- Kalimi i Qendres Kulturore Margarita Tutulani ne nje artraksion turistik te vizitushem. Realizimi i ketije objektivi do te behet duke krijuar ambjente te pershtatshme per te qene ne atraksion turistik nepermjet ngritjes se muzeut historik dhe vendosjen e ambjenteve te galerise se Arteve ne dispozicion te turistave qe vizitojne qytetin.
- 4- Ringritja e muzeut Historik Qendra Kulturore Margarita Tutulani disponon ne inventar objekte te muzeut historik te cilat mund ti shfrytezoje ne aritjen e ketije objektivi.

**PRODUKTET** jane lista e aktiviteve trajtuar ne shpenzimet e Q.Kulturore”M.Tutulani”.





**b. N/programi Galeria e Arteve "Eduard Lear".Përshkrimi.** Programi parashikon permiresimin e metejsheem te galerise se arteve jo vetem ne drejtimte aktiviteteve dhe shtimit te tyre sasior por per ta mbeshitetur me investime per krijimin e e ambjenteve me te kompletuara e bashkekohore. Rritja e fondit te galerise me vepra te autoreve te rinj.

**Politika e Programit.**Politika e këtij programi synon gjallerimin e jetes rinore dhe kulturore ne qytet nepermjet zhvillimit te aktiviteteve te programuara vit pas viti duke krijuar mundesi reale per zgjerimin e saj si ne fushen e pjesmarresve e vizitoreve ashtu dhe ne vlerat kulturore qe mbart fondi i saj.

**Njesia Shpenzues:** Bashkia Berat, Qendra Kulturore ,Donatore

#### **Objektivat e politikës së programit**

- ❖ Shtimin e fondit te Galerise.
- ❖ Krijimin e hapesirave te nevojshme dhe te mjaftueshme per ruajtjen mirembajtjen dhe ekspozimin e fondit te saj.
- ❖ Evidentimin e talenteve te reja ne piktore e skulpture e per tradite dhe ne artizanat.. Promovimin dhe shtimin e numrit te vizitoreve duke e kthyer ate nje pike te rendesishme te axhentes turistike ne qytet.

#### **Produktet që synohen të ofrohen;**

1. Shtimi dhe ruajtja e mirembajtja e fondit te galerise.
2. Realizimi i listes se aktiviteteve dhe zgjerimi i saj mbi bazen e kapaciteteve financiare te nevojshme dhe te mjaftueshme qe do te krijohen.
3. Zgjerimi dhe kompletimi i ambjenteve ne funksion te krijimit te kushteve bashkohore.

**N/programi Biblioteka "Vexhi Buharaja".Përshkrimi.**Programi i Bibliotekes parashikon rritjen e fondit te bibliotekes, mirembajtjen e tyre, dhe shtimin e numrit te lexuesve per te gjithë grupmoshat.

**Politika e Programit.** Politika e këtij programi synon shtimin e fondit te materialeve te bibliotekes, zhvillimin e aktivitetve promovuese e nxitese ne funksion te shtimit te lexuesve e kryesisht atyre te rinj ne funksion te promovimit kultures dhe edukimit.

**Njësitë shpenzuese.** .Bashkia Berat, Qendra Kulturore,Donatore

#### **Objektivat e politikës së programit**

1. Pasurimi i fondeve te bibliotekes me libra dhe periodike.
2. Rritja e nr. te rekordeve bibliografike te klasifikimit elektronik.
3. Rritja e nr. te lexuesve dhe frekuentuesve te bibliotekes.







## BASHKIA BERAT

4. Bashkepunimi me shkollat e sistemit arsimor te Beratit, shoqatat dhe entet kulturore dhe sociale ne funksion te gallerimit te jetes kulturore – letrare te komunitetit
5. Promovimi i krijimtarise dhe produktit letrar lokal dhe kombetar.

### Produktet që synohen të ofrohen

1. Ruajtja e mirembajtja e fondit te bibliotekes ne numer dhe shtimi i tij duke e pasuruar me libra e materiale te tjera te nevojshme per te gjithë grup moshat.

Nr.	Sektoret	Tituj	Ekzemplare
1	Libri shqip	16.673	33.730
2	Libri per femije	2.666	6.636
3	Periodiku shqip	200	5.126
-	Periodiku i huaj	120	3.153
-	Libri i huaj	9.200	13.270
<b>Gjithsej</b>		<b>28.859</b>	<b>61.915</b>

2. Organizimi i aktiviteteve rinore qe nxisin kulturen e te lexuarit.

C-Frekuentimi :

Nr.	Sektoret	Frekuentues ditore	Lexues ne salle
1	Libri shqip	50	12
2	Libri per femije	30	20
3	Periodiku dhe libri i huaj	25	25
<b>Gjithsej</b>		<b>105</b>	<b>57</b>

3. Ofrimi i mundesise, qe lexuesit e rinj ne menyre online te lexoje koleksionin e veprave te bibliotekes.

Anetaresia :

Nr.	Sektoret	Nr. Lexuesve te kartelizuar
1	Libri shqip	510
2	Libri per femije	450
3	Periodiku dhe libri i huaj	150
<b>Gjithsej : 1.110</b>		

**N/programi Turizmi. Pershkrimi.** Angazhimi i Bashkisë për zhvillimin e turizmit, për ta shndërruar qytetin në një destinacion cilësor, të zhvilluar mbi parimet e qëndrueshmërisë.

**Politika e Programit.** Programi mbështetet në parimet e CILËSISË dhe QËNDRUESHMËRISË– cilësia dhe vlerat mbështetur në eksperiencën e vizitorëve; produktet dhe shërbimet me cilësi që paraqesin vlerën unike të Beratit; në harmoni me mjedisin; dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për qytetarët e Beratit – këto gjëra, së bashku, do të sigurojnë





qëndrueshmërinë e turizmit në Berat.

**Njësitë shpenzuese:** Bashkia Berat, Donatore, partner vendas dhe huaj.

**Objektivat e politikës së programit.**

- Te arrihet që Berati të jetë një destinacion i njohur, mbështetur në trashëgiminë kulturore natyrore dhe shpirtërore, duke ofruar shërbime dhe eksperiencë unike në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Të arrihet një zhvillim i harmonizuar dhe afatgjatë i turizmit, mbështetur në parimet e qëndrueshmërisë.
- Të arrihet një jetë më e mirë ekonomike dhe shoqërore për qytetarët e Beratit, duke ofruar mundësi punësimi dhe rritje të të ardhurave përmes zhvillimit të turizmit.

**Produktet që synohen të ofrohen.**

1. Zhvillimi i një pakete promovionale e cila të jetë me cilësi bashkëkohore europiane.
2. Zhvillimi i aktiviteteve të Drejtorisë së Kulturës konkretisht aktivitetet për turizmin.
3. Risi në qytetin e Beratit është eksplorimi i qytetit me bicikleta (Ecja me bicikleta)
4. Pjesë mjaft e rëndësishme është zhvillimi i tregut të artizanatit, mundësi shumë e mirë promovimi vlera dhe padyshim rritje e ekonomisë.
5. Zhvillimi i infrastrukturës për dhënie të informacionit në zyrën e Interpretimit Turistik;
6. Zhvillimi dhe nxitja e të paktën katër bizneseve të vogla dhe të mesme në fushën e turizmit.
7. Krijimi i të paktën një fshati turistik,
8. Krijimi i tureve lokale.
9. Promovimi i kuzhinës tradicionale të Beratit nëpërmjet organizimit të panairëve.
10. Zhvillimi dhe promovimi i SME-ve në agrobiznes dhe agroturizëm nëpërmjet pjesëmarrjes së panairëve.
11. Përmirësimi i aksesit dhe transportit në Kalanë të Beratit me ndihmën e projektit PTID të Bankës Botërore.

**Projekte:**

1	<b>Programi</b>	<b>Promovimi i Turizmit Kulturor dhe Natyror</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Ditët e Turizmit në Berat</b>
3	<b>Kohëzgjatje</b>	4 Ditë
4	<b>Data e fillimit</b>	Shkurt 2017
5	<b>Donator potencial</b>	CESVI; BID Berati
6	<b>Kostoja totale</b>	8.244.500
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	44.500 + burime tjera
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Promovim i produkteve të agrobiznesit dhe artizanatit; Promovimi i





BASHKIA BERAT

		qytetit si një destinacion turistik; Përfshirja dhe sensibilizimi i i të rinjve
10	<b>Objektivat</b>	Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm duke ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore
11	<b>Indikatorët</b>	Numri i pjesëmarrësve në panaire; Numri i personave në komunitet të angazhuar; Ndikimi në imazhin e qytetit; numri i produkteve për promovimin e qytetit etj.
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Projekti do të zhvillohet përgjatë tre ditëve, në fillim të muajit Maj. Në ditën e parë do të organizohet aktiviteti Trinkat e Beratit si dhe një pastrim gjithëpërfshirës i Bashkisë së re të Beratit. Në ditën e dytë dhe në ditën e tretë do të organizohet një panair kombëtar me produktet më të mira të turizmit kulturor në Berat, i cili do të përmbajë artikuj të artizanatit dhe agro-biznesit.  Në panair do të marrin pjesë artizanë nga të gjitha trevat e Shqipërisë si dhe do të organizohet parada e kostumeve popullore kombëtare. Gjithashtu do të promovohet edhe paketa e re turistike e qytetit.
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	Bashkia Berat, CESVI, BID Berati;
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
15	<b>Shënime</b>	

1	<b>Programi</b>	<b>Përmirësimi i Dhënies së Informacionit për Turistët në Bashkinë Berat</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Përmirësimi i Infrastrukturës në Zyrën e Interpretimit Turistik</b>
3	<b>Kohëzgjatje</b>	6 Muaj
4	<b>Data e fillimit</b>	Janar 2017
5	<b>Donator potencial</b>	Cesvi
6	<b>Kostoja totale</b>	800.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	Burime Njerëzore
8	<b>Fond shtesë</b>	800.000 CESVI
9	<b>Rezultatet</b>	- Veshje e plote e jashtme me adeziv e Zyres se Interpretimit Turistik - Tavoline recepsioni - Kondicionim te ambientit - Krijimi i kendit të punës - Kompjuter dhe Laptop
10	<b>Objektivat</b>	- Permiresimi i Kushteve te Punes - Rritja e performances se stafit ne zyren e turizmit - Rritja e imazhit reklamues te zyrës turistike - Rritja e cilësisë së shërbimit në zyrë



**BASHKIA BERAT**

11	<b>Indikatorët</b>	- Sasia e pajisjeve të blera ne zyren e Interpretimit Turistik - Performanca e stafit turistik ne Zyrë - Anketimet e kryera me turistë
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	- Përcaktimi i pajisjeve për tu blerë në zyrë - Blerja e Pajisjeve për Zyren e Turizmit - Vendosja në përdorim e pajisjeve
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	CESVI; Bashkia Berat
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria Kulturës, Turizmit, Rinisë, Sporteve
15	<b>Shënime</b>	

1	<b>Programi</b>	<b>Promovimi Turistik i Qytetit Berat</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Krijimi i Paketës Turistike Berat</b>
3	<b>Kohëzgjatje</b>	1 Vit
4	<b>Data e fillimit</b>	Janar 2017
5	<b>Donator potencial</b>	CESVI
6	<b>Kostoja totale</b>	500.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	Burime njerëzore dhe infrastrukturore
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Krijimi i paketës e cila do të përmbajë:  1. Itinerare për Bashkinë dhe Rajonit Berat; 2. Atraksione dhe produkte turistike në qytet 3. Oferta të bizneseve turistike
10	<b>Objektivat</b>	- Krijimi i një pakete turistike e cila promovon ofertat kryesore turistike në qytet. - Rritja e produkteve turistike të vizitura në Bashkinë Berat; - Rritja e shpenzimeve turistike në Bashkinë Berat





## BASHKIA BERAT

11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i produkteve dhe ofertave turistike të promovuara - Numri i broshurave dhe fletëpalosjeve të publikuara si pjesë e paketës turistike - Numri i bizneseve të promovuara - Numri i turistëve që vizitojnë produktet e promovuara
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	- Mbledhja e materialeve dhe fotove - Përshtatja e informacionit - Dizajnimi i paketës turistike dhe printimi i saj
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	CESVI; Bashkia Berat
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve
15	<b>Shënime</b>	


**N/program. Trashëgimia Kulturore dhe Artet. Përshkrimi.** Ruajtja dhe promovimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore në Berat, si një aset universal për zhvillim kulturor, social dhe ekonomik.

**Politika e Programit.** Qëllimi i përgjithshëm i punës është ruajtja, përmirësimi, promovimi i trashëgimisë botërore së prekshme dhe të paprekshme në Bashkinë Berat, në shërbim të komunitetit të qytetit dhe atij kombëtar dhe ndërkombëtar.

**Njesia Shpenzuese ;** Bashkia Berat, Donatorë

### **Objektivat e politikës së programit;**

- Zhvillimin e projekteve që kanë si qëllim përfitimin kulturor, ekonomik dhe social të banorëve të qytetit të Beratit nga trashëgimia kulturore.
- Bashkëmenaxhimi dhe monitorimi i trashëgimisë kulturore Berat sipas kriterëve dhe udhëzimeve të përshkruara nga UNESCO.
- Ruajtja, promovimi dhe nxitja e traditave të artizanatit. Zhvillimin e aftësive të artizanëve beratas për të ruajtura dhe zhvilluar aftësitë e tyre për të përfituar nga zejet e vjetra.
- Zhvillimi i projekteve të cilat kanë si qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve për ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore.
- Promovimi i trashëgimisë në arenën ndërkombëtare dhe krijimin i lidhjeve me partnerë të ngjashëm Evropian për të mundësuar dialog dhe bashkëpunim kulturor ndërmjet qytetarëve.

 Koordinim për krijimin dhe aplikimin e projekteve në fushën e trashëgimisë.



**Produktet e ofruara do të konsistojnë në disa fusha:**

1. Një sistem dixhital menaxhimi i trashëgimisë do të shërbejë për përmirësimin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Berat. Në këtë kuadër do të ngrihet edhe një grup për bashkëmenaxhimin e Qendrës Historike në bashkëpunim me qytetarët. Grupi i themeluar do të quhet Forumi për Menaxhimin e Integruar të Trashëgimisë Kulturore. Përmes themelimit të Konferencës për Menaxhimin e Qyteteve Historike në UNESCO do të krijohet një platformë për shkëmbimin e dijeve dhe eksperiencave ndërmjet ekspertëve dhe administruesve të trashëgimisë kulturore në mbarë Shqipërinë.
2. Në fushën e rritjes së ndërgjegjësimit & kapaciteteve të komunitetit do të vijoj Kampi Trashëgimi+ do të synoj të aftësoj dhe informojë të paktën 20 të rinj dhe të reja nga qyteti. atit.
3. Ky program synon të nxisë edhe trashëgimnë shpirtërore, përmes rritjes së gamës së produkteve të artizanatit dhe krijimit të serive të katalogëve për trashëgiminë shpirtërore Berat. Do të krijohen të paktën dhjetë produkte të reja artizanati në formë suveniresh, si dhe do të krijohet seria e parë e katalogëve.
4. Investimet strategjike të cilat do të kryhen nga partnerët strategjik të Shqipërisë, si Komisioni Evropian, BERZH, Banka Botërore etj. Disa nga projektet që janë duke u shqyrtuar janë Restaurimi i Cisternës Mesjetare në Kala, Restaurimi i Akropolit, Restaurimi i Rrugës ish-Merkato-Qafa e Kalasë, Restaurimi i Kullës së Tabjes, Ndërtimi i një Parkingu në Lagjen Kala, Rehabilitimi i Daljes së Fshehtë etj.

**LISTA E PROJEKTEVE**

1	<b>Programi</b>	<b>Aktivite Vjetore për Trashëgiminë Kulturore</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	18 Prill - Dita e Monumenteve dhe Siteve - Çmimi për Restaurimin më të mirë
3	<b>Kohëzgjatje</b>	1 Ditë
4	<b>Data e fillimit</b>	15 Shkurt
5	<b>Donator potencial</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	95.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	95.000
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Ndërgjegjësimi dhe komunikimi i mesazhit të të paktën 40 banorë të Qendrës Historike.
10	<b>Objektivat</b>	Rritja e Ndërgjegjësimit dhe motivimi i banorëve për ruajtjen e pronave të tyre që janë trashëgimi kulturore
11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i pjesëmarrësve; Përcjellja e mesazhit; - Komente dhe sugjerime nga të pranishmit; - Mbulimi mediatik
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Praktika e mirë restauruese e një banore ose kontributi i një





BASHKIA BERAT

		personaliteti në fushën e trashëgimisë kulturore do të vlerësohet me anë të konsultimeve të përbashkëta midis Bashkisë Berat dhe DRKK Berat.
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	Ceremonia e dhënies së çmimit do të bëhet në Galerinë e Arteve Edëard Lear. Gjatë dhënies së çmimit do të organizohet një ekspozitë me fotografi nga materialet e restauruara, fotografi nga punimet restauruese të kryera nga Bashkia Berat dhe Drejtoria e Kulturës Kombëtare Berat etj.
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Gjithashtu do të krijohet edhe një prezantim në poëer point ku do të shpjegohen vlerat dhe elementët e vlerave të trashëgimisë së ruajtur si dhe mënyra se si janë ruajtur këto vlera.
15	<b>Shënime</b>	Pas përfundimit të ceremonisë një grup i vogël do të bëj vizitën në objektin e restauruar për të parë më nga afër punimet

1	<b>Programi</b>	<b>Dixhitalizimi dhe Monitorimi i Trashëgimisë Kulturore</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	Trashëgimia Botërore në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) dhe Monitorimi Fotografik i Trashëgimisë Kulturore
3	<b>Kohëzgjatje</b>	9 Muaj
4	<b>Data e fillimit</b>	Mars 2018
5	<b>Donator potencial</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	200.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	100 000 + burime njerezore
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Pas hedhjes së plotë të të dhënave në sistemin GIS, monumentet dhe gjendja e qendrës historike do të mund të studiohen me shumë imtësi në varësi të nevojave. Do të mund të studiohet gjendja e dëmtimit të monumenteve, statusi social dhe ekonomik i banorëve, braktisja e qendrës historike
10	<b>Objektivat</b>	Ky ushtrim do të kryhet çdo vit me qëllim për të parë dhe njohur evoluimin e ndryshimeve që ndodhin në arkitekturën e trashëguar dhe në vlerën e jashtëzakonshme universale si dhe për të njohur dhe adresuar nevojat e komunitetit në Qendrën Historike.
11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i monumenteve në GIS; - Paketa e Plotë e Fotografive për monitorimin e Qendrës Historike;
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	I gjithë siti Berat do të ngarkohet në sistemin GIS, cili do të regjistrojë vendndodhjen e pasurive kulturore si dhe informacion shtesë, në lidhje me gjendjen e monumenteve,





## BASHKIA BERAT

		pronësinë, kushtet social-ekonomike të banorëve. Informacione, të dhëna dhe meta-data do të shtohen për çdo monument të cilat do të pasqyrohen në harta dixhitale. Gjithashtu synohet të monitorohet me anë të fotografive qendra historike Berat
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	Bashkia Berat
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve
15	<b>Shënime</b>	Dixhitalizimi dhe Monitorimi i Trashëgimisë Kulturore

1	<b>Programi</b>	<b>Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore dhe Përcjellja e saj te Brezat e rinj</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	Kampi Trashëgimi +
3	<b>Kohëzgjatje</b>	3 Javë
4	<b>Data e fillimit</b>	14 Qershor 2017
5	<b>Donator potencial</b>	CHëB
6	<b>Kostoja totale</b>	514.500
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	314.500
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	20 të rinj trajnohen në fushën e konservimit dhe të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Një pjesë e pa konservuar e qendrës Historike konservohet. Të rinjtë kanë më shumë mundësi të angazhohen në jetën e qytetit dhe të shkëmbejnë njohuri dhe eksperiencë me moshatarë të tjerë jashtë Shqipërisë.
10	<b>Objektivat</b>	Qëllimi i këtij kampi është zhvillimi i qytetarisë aktive ndërmjet të rinjve, sensibilizimi i të rinjve mbi rëndësinë e trashëgimisë sonë kulturore dhe burimeve natyrore dhe zhvillimi i mirëkuptimit ndërkombëtar dhe aftësive ndërkulturore
11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i Pjesëmarrësve; - Vlerësim I Eksperiencës; - Sasia dhe cilësia e konservuar e Trashëgimisë
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Tre programe kryesore janë përgatitur për t'u kryer në teori dhe në praktikë gjatë kampit. Programet janë të mësuarit ndërkulturore, restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe promovimin e mjedisit/eko-turizmit
13	<b>Organizata/Institucioni</b>	Bashkia Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të







## BASHKIA BERAT

	<b>zbatues</b>	Kulturës Kombëtare, Korpusit të Paqes në Shqipëri, Boyscouts of France dhe Aleancës Franceze Berat
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe sporteve
15	<b>Shënime</b>	Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore dhe Përcjellja e saj te Brezat e rinj

1	<b>Programi</b>	<b>Aktivitetet Vjetore për Promovimin e Trashëgimisë Kulturore</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	29 Shtator - Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore
3	<b>Kohëzgjatje</b>	3 Muaj
4	<b>Data e fillimit</b>	8 Korrik 2018
5	<b>Donator potencial</b>	ChëB dhe Komisioni Evropian dhe programet 4ALL dhe CultureLands
6	<b>Kostoja totale</b>	565.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	100.000
8	<b>Fond shtesë</b>	465.000
9	<b>Rezultatet</b>	Afrimi i studiuesve dhe menaxherëve kombëtar dhe ndërkombëtar në qytetin e Beratit për të ofruar zgjidhje për problemet bashkëkohore të trashëgimisë kulturore; Përditësimi i planit të menaxhimit Berat dhe Gjirokastër; afrimi i administratorëve të siteve shqiptare; afrimi i donatorëve
10	<b>Objektivat</b>	Nxitja e zgjidhjeve pozitive të problemeve me të cilat haset trashëgimia kulturore në Berat;
11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i ekspertëve të huaj; - Plan propozimet e krijuara;
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Në datën 29 Shtator do të organizohet Konferenca Kombëtare "Sitet e Trashëgimisë Shqiptare në UNESCO – Berat, Gjirokastër, Butrint". Qëllimi i kësaj konference do të jetë afrimi i studiuesve dhe praktikave më të mira të menaxhimit të trashëgimisë kulturore në vend dhe në rajon. Pjesëmarrës do të jenë grupe interesi, donatorë, përfaqësues institucionesh etj.
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	Bashkia Berat
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
15	<b>Shënime</b>	Aktivitetet Vjetore për Promovimin e Trashëgimisë Kulturore

1	<b>Programi</b>	<b>Zhvillimi i Artizanatit në Qytetin e Beratit</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	Krijimi i Suvenireve Karakteristike për Qytetin e Beratit
3	<b>Kohëzgjatje</b>	3 Muaj





BASHKIA BERAT

4	<b>Data e fillimit</b>	Shtator 2018
5	<b>Donator potencial</b>	Risi Albania
6	<b>Kostoja totale</b>	315.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	50 .000
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Me anë të këtij projekti synohet të shtohen numri i suvenirëve karakteristikë me të paktën 20 punime të reja dhe krijuese. Gjithashtu synohet të trajnohen 15 artizanë në teknika të reja
10	<b>Objektivat</b>	Me anë të këtij produkti synohet që t'i jepet shtysë zhvillimit dhe krijimit të suvenirëve të reja në qytetin e Beratit
11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i artizanëve të trajnuar, - Numri i suvenireve të krijuara. - Numri i produkteve të reja që hyjnë në prodhim.
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Artistë dhe artizanë të qytetit do të ftohen që të modelojnë suvenire të cilat mund të jenë dalluese dhe karakteristike për qytetin e Beratit.
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	Gjatë projekti do të sigurohet një udhëtim studimor për artistë grafike dhe artizanë të qytetit të cilët mund të punojnë për krijimin e suvenireve në grup. Udhëtimet Studimore parashikohen të kryhen në Metsovo dhe në Ulqin. Artizanët do të prezantohen me forma dhe lloje të ndryshme suveniresh si dhe lloje të ndryshme biznesi të krijuar me to.
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Artistë dhe specialistë të grafikës do të orientojnë artizanët për të mësuar teknikat për krijimin e suvenirëve tërheqëse për vizitorët dhe klientët në përgjithësi.
15	<b>Shënime</b>	Në përfundim, artizanët dhe artistët do të krijojnë suveniret e posaçme me të cilat do të krijohet një ekspozitë si dhe një konkurs ku do të shpallen edhe tre suveniret më të mira të krijuara dhe të cilat do të shumëfishohen më vonë për të identifikuar qytetin e Beratit

1	<b>Programi</b>	<b>Ruajtja dhe promovimi i Trashëgimisë Shpirtërore</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	Dokumentimi i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore (Krijimi i Serive të Katalogëve të Trashëgimisë Shpirtërore)
3	<b>Kohëzgjatje</b>	11 Muaj
4	<b>Data e fillimit</b>	1 Shkurt 2018
5	<b>Donator potencial</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	420.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	120.000 + burime njerezore
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Me anë të këtij projekti synohet që të dokumentohet trashëgimia kulturore jo-materiale në qytetin e Beratit.





BASHKIA BERAT

		Këngë, valle, instrumente, gojëdhëna, legjenda, tradita, letërsi, teknika punimi etj. do të jenë pjesë e dokumentimit të Trashëgimisë shpirtërore
10	<b>Objektivat</b>	Objektivi e këtij projekti është mbledhja dhe dokumentimi i trashëgimisë sonë shpirtërore dhe njohja e saj në një masë edhe më të madhe nga qytetarët;
11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i zhanreve e dokumentuara; - Forma e dokumentimit; - Mënyra dhe aktivitetet e promovimit
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Të gjitha atributet e trashëgimisë shpirtërore kulturore do të dokumentohen në formularë të posaçëm të krijuar enkas për dokumentimin.
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	Pas dokumentimit do të krijohet edhe një katalog i posaçëm me emërtimet dhe përshkrimet e çdo atributi të trashëgimisë shpirtërore.
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Këtotribute do të promovohen edhe në mënyrë dixhitale, duke u vendosur në serverin e Bashkisë Berat si dhe në faqen e internetit të Bashkisë Berat.
15	<b>Shënime</b>	Do të krijohet seria e katalogëve të trashëgimisë shpirtërore Berat.

1	<b>Programi</b>	Ruajtja e Traditës dhe Zakoneve në Qytet
2	<b>Titulli i projektit</b>	Dita e Gatimeve Tradicionale
3	<b>Kohëzgjatje</b>	3 muaj
4	<b>Data e fillimit</b>	Tetor 2018
5	<b>Donator potencial</b>	BID dhe CESVI
6	<b>Kostoja totale</b>	300.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	75.000
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Promovimi i gatimeve si një shenjë e identitetit të qytetit; vazhdimi i një feste mjaft popullore në qytet
10	<b>Objektivat</b>	- Ruajtja e Traditës në Qytetin e Beratit; - Zhvillimin e Imazhit turistik në qytet; - Rritja e jetës kreative;
11	<b>Indikatorët</b>	Numri i pjesëmarrësve; numri i turistëve; kënaqësia e pjesëmarrësve
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Në panairin e gatimeve tradicionale do të marrin pjesë studentë të Shkollës Hoteleri Turizëm Kristo Isak, Kursit Profesional Leta, si dhe gra anëtare të Qendrës së Artizanatit Margarita. Këtyre subjekteve do t'u shpërndahen ushqime kryesisht nga rajoni i Beratit për të krijuar me to gatime tradicionale.
13	<b>Organizata/Institucioni</b>	Panairit do t'i paraprijë një seancë informimi 3-ditore ku do





BASHKIA BERAT

	<b>zbatues</b>	të shpjegohen gatimet tradicionale të Beratit për të gjitha subjektet. Seancat e Informimit do të zhvillohen nga mjeshtri i gatimeve Josif Mio së bashku me stafin e Bashkisë Berat. Gjatë informimit do të shpërndahen recetat e gatimeve tradicionale.
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Gatimet e prodhuara gjatë trajnimeve, subjektet do t'i reklamojnë dhe shesin në Ditën e Gatimeve Tradicionale. Produktet do të shiten me çmime simbolike për t'u mundësuar shtresave në nevojë të popullatës që të mund të bëhen pjesë e këtij aktivitetit në fundvit. Subjektet do të kenë në Panairin e Gatimeve Tradicionale standën e tyre që do të ofrohet nga Bashkia Berat dhe BID Berati.
15	<b>Shënime</b>	Në panair do të ftohen të marrin pjesë të gjitha bizneset e interesuara në fushën e gatimit, ushqimit dhe agrobiznesit. Në sheshin kryesor do të jenë edhe biznese të produkte të zgarës.
1	<b>Programi</b>	<b>Trashëgimi Kulturor për Turizëm të Qendrueshëm</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	Rehabilitimi Mjedisor i Lagjes Mangalem
3	<b>Kohëzgjatje</b>	7 Muaj
4	<b>Data e fillimit</b>	Prill 2017
5	<b>Donator potencial</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	800.000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	Burime njerezore
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	Me anë të këtij projekti pilot në Lagjen Mangalem synohet të krijohen kushtet e nevojshme për ruajtjen e pastër të qendrës Historike. Synohet Menaxhim i ndryshëm i mbetjeve, largimi i qeseve me mbeturina nga rrugicat e lagjes dhe mbledhje e diferencuar e mbetjeve në përputhje me statusin e Lagjes si një qendër e vizitueshme botërore.
10	<b>Objektivat</b>	Kushte për një mjedis të pastër dhe mbledhje pilot e diferencuar e mbetjeve.
11	<b>Indikatorët</b>	- Numri i koshave të vendosur; - Gjendja e pastrimit në lagje; - Përdorimi i koshave nga banorët.
12	<b>Aktivitetet kryesore</b>	Në zona të caktuara të lagjes do të vendosen kosha për mbetjet familjare. Parashikohen që të vendosen 10 sete koshash në 10 vende të caktuara. 1 set koshash do të synojë të grumbullojë mbetjet e 10 familjeve. Koshat do të jenë të ndarë për mbetje plastike si dhe për mbetje të përgjithshme
13	<b>Organizata/Institucioni zbatues</b>	Bashkia Berat
14	<b>Struktura Përgjegjëse</b>	Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve
15	<b>Shënime</b>	Trashëgimi Kulturor për Turizëm të Qendrueshëm





## BASHKIA BERAT

---

**N/programi. Marrëdhëniet me Jashtë. Përshkrimi.** Gjetja e burimeve alternative të financimit për projektet e Bashkisë Berat dhe plotësimi shpeshherë i bashkëfinancimit me burimet njerëzore të Bashkisë.

**Politika e Programit.** Politika e këtij programi synon të koordinojë marrëdhëniet dhe projektet me institucione dhe partnere nderkombetare dhe të ndjeke veprimtarinë me jashtë të administratës së Bashkisë Berat.

**Njesia Shpenzuese:** Bashkia Berat, Partnere Nderkombetare.

### **Objektivat e politikës së programit;**

- Te negociojë dhe krijojë partneritetet me organizata, donatore dhe aktore nderkombetare , për mbështetjen e projekteve bilaterale
- Te nxisë bashkëpunimet me bashkitë dhe komunat binjake të qytetit , për të aplikuar projekte të përbashkëta në fusha të ndryshme, dhe të kërkojë për lidhje të reja në fushën e binjakezimit midis institucioneve të qeverisjes vendore.
- Te kujdeset për hartimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Europian.
- Te organizojë veprimtarinë me jashtë të administratës së bashkisë
- Te nxisë dhe bashkëpunojë për promovimin e qytetit në fushën nderkombetare.\

### **Produktet që synohen të ofrohen;**

- Gjetjen e burimeve alternative të financimit të projekteve të saj. Për vitin 2018 janë tre projekte me financime të huaja:
  - ✓ Projekti me Bankën Botërore, për financimin e Projektit të Zhvillimit të Turizmit për Shqipërinë e Jugut, pas ratifikimit të Marrëveshjes në Parlamentin Shqiptar, pritet të fillojë në Qershor 2017 dy investime të rëndësishme në qytet që janë dy rruget lidhëse me kalane.
  - ✓ Me Kooperacionin Zvicerian është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit për projektin “Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane në Rajonin e Beratit”, projekt i cili do të shtrihet në një periudhë kohore 5- vjeçare dhe do të bëjë të mundur studimin për menaxhimin e mbetjeve në gjithë territorin e Rajonit të Beratit dhe ngritjen e një landfilli, i cili do të përpunojë mbetjet e diferencuara .
  - ✓ Vazhdon intensivisht puna për rehabilitimin e rrjetit ujësjellës - kanalizime, nëpërmjet kredisë së Bankës Gjermane KFW, investim i cili do të zgjidhë brenda vitit 2018 furnizimin me ujë të qytetit të Beratit.
- Aplikimi për çdo thirrje për projekte nga partnerët e huaj dhe do të vazhdojmë me





intensitet kontaktet dhe bashkëpunimin me : Bashkitë Binjake ,Rrjetet Ndërkombëtare ,Organizatata dhe donatorë ,Projektet e Bashkimit European.

#### **N/programi. Sporti.**

**Përshkrimi.** Masivizimin dhe konsolidimin e sistemit sportiv, përfshi te gjitha disiplinat sportive, në dobi të shëndetit të shoqërisë sonë që nga fëmijët e kopshteve, të rinjtë, studentët dhe të rriturit.

**Politika e Programit.** Politika e këtij programi synon nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesëmarrjes ne aktivite kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Njësitë shpenzuese,** Bashkia Berat, Donatore dhe partner.

Klubi i Futbollit “FK Tomori 1923” sh.a. finanohet 100 % nga Bashkia , si aksionare e vetme ne kete Sh.a..

Klubi shumë-sportit “Tomori”, vijon te mbeshtetet ne menyre modeste nga Bashkia.

#### **Objektivat e politikës së programit**

- a. Vazhdimi i ecurise drejt ngitjes se ekipit te futbollit ne nivelet me te larta ne kategorie superiore, aktualisht ndodhemi ne kategorie e pare.
- b. Vemendje do te vijoj ti kushtohet edhe ekipeve zinxhir te moshave U-17, U-19.si dhe formimi i nje akademie te mirefillte futbollit.
